STRATEGJIA

PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

2022 - 2028



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

STRATEGJIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2022 – 2028

Prishtinë, dhjetor 2021

Akronimet dhe shkurtesat

AZHB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
PBZHR	Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
PPB	Politikat e Përbashkëta Bujqësore
PD	Pagesat Direkte
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
RRDHKF	Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave
FAO	Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit e Kombeve të Bashkuara
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
HACCP	Analiza e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit
IPARD	Instrumenti i Para-anëtarësimit për Zhvillim Rural
AM	Autoritet Menaxhues
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
BMA	Bimët mjekësore dhe aromatike
OJQ	Organizatë joqeveritare
PPJD	Produktet pyjore jodrusore
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet
NUTS	Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat
LAU	Njësitë administrative lokale
ZKM	Zyra për Planifikim Strategjik
OZHQ	Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
SHPU	Shoqata e përdoruesve të ujit
IADK	Iniciativa për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës
GIZ	Shoqëria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar
GLV	Grupet lokale të veprimit
KMBM	Kushtet e mira bujqësore dhe mjedisore

Definicionet

Elasticitet i fermës	Nënkupton kapacitetin e fermerëve për të vazhduar bujqësinë në rast të rënies së të ardhurave afatshkurtra të fermës, qoftë për shkak të prodhimit të ulët, çmimeve të ulëta ose kostove të larta, si rezultat i krizave ekonomike ose natyrore.
Bujqësia digjitale	Bujqësia digjitale është përdorimi i teknologjisë digjitale për të integruar prodhimin bujqësor nga ara tek konsumatori. Këto teknologji mund t'i ofrojnë industrisë bujqësore mjete dhe informacion për të marrë vendime më të informuara dhe për të përmirësuar produktivitetin.
Shërbimet e ekosistemeve Mbështetja e çiftëzuar/ Coupled	Janë sisteme të larmishme për njerëzit që ofrohen nga mjedisi natyror dhe nga ekosistemet e shëndetshme. Ekosisteme të tilla përfshijnë, për shembull, agro-ekosistemet, ekosistemet pyjore, ekosistemet kullosore dhe ekosistemet ujore.Nënkupton mbështetjen e të ardhurave të fermës lidhur me prodhimin, pra ose e paguar për ton në rastin e drithërave ose për kokë të kafshëve.
Mbështetja e shkëputur / Decoupled	Nënkupton mbështetjen e të ardhurave të fermës që nuk lidhet me prodhimin, që do të thotë se pagesa bëhet për ha (pavarësisht nga niveli i prodhimit apo edhe nëse toka është e kultivuar apo jo) dhe për numrin e kafshëve në pronësi të fermerit.
Indeksi i shpendëve në tokës bujqësore	Është një tregues i ndikimit të ndërlidhur të biodiversitetit në raport me tokën bujqësore, duke marrë parasysh pasurinë në shpendë si tregues të intensitetit të bujqësisë. Shpendët janë të lidhur me përdorimin e pesticideve nëpërmjet insekteve dhe me veçoritë e peizazhit, si pemët e izoluara apo grupet e pemëve dhe studimet tregojnë se bujqësia intensive ka një ndikim të rëndësishëm në uljen e numrit dhe llojeve të shpendëve që lidhen me tokën bujqësore.
Shërbimet Këshillimore në Fermë	FAS nënkupton shërbimin këshillimor në fermë që shpjegon se si fermerët të pajtohen me ndër-përputhshmërinë / cross-compliance (e detyrueshme në çdo shtet anëtar të BE-së).
Kullota me vlerë të lartë (HNVG)	Kullota me vlerë të lartë natyrore konsiderohen të gjitha livadhet (si livadhet ashtu edhe kullotat) nën menaxhim të gjerë, që do të thotë që nuk janë të plehëruara kimikisht, kulloten gjerësisht (deri në 2 njësi blegtorale për ha) dhe kositen vonë (duke u dhënë mundësinë bimëve për të prodhuar fara).
IACS – Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit	Është sistemi i TI që përdoret për të administruar të gjitha kërkesat për pagesa të fermerëve, duke përfshirë konkluzionet e kontrolleve administrative dhe në vend, sanksionet e aplikuara dhe autorizimin e pagesës, deri në pagesën e regjistruar dhe të certifikuar.
GLV - Grupet Lokale të Veprimit	Janë shoqata private-publike në zonat rurale dhe qytetet e vogla (partnerët privatë që përfaqësojnë më shumë se 50% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve) që synojnë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal, duke marrë parasysh nevojat dhe mundësitë lokale. Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së kërkon që të paktën 5% e fondeve të zhvillimit rural të zbatohen përmes GLV-ve.

LPIS – Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës	Është sistemi TI i cili përfshin një hartë të digjitalizuar të tokës bujqësore (të zhvilluar në bazë të orto-fotove) në nivelin e të paktën blloqeve fizike, duke përfshirë të gjitha parcelat bujqësore me vazhdimësi të përdorimit nën të njëjtin lloj (ara, kullota të përhershme, pemishte ose vreshta).
Rrjeti Kombëtar Rural	Është një ombrellë e akterëve më të rëndësishëm ruralë, si shoqatat e fermerëve, përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, OJQ-të, përfaqësuesit e komunave dhe autoriteteve të tjera lokale, me rolin e përfaqësimit të interesit të anëtarëve të tyre në përgatitjen dhe zbatimin e strategjive dhe programeve, si dhe në shpërndarjen e informacionit tek anëtarët e tyre.
Zinxhir i shkurtër i furnizimit	Marrëdhëniet midis një prodhuesi dhe tregut, i cili përfshin maksimum një tregtar. Ky koncept synon të inkurajojë konsumin e produkteve vendore, duke promovuar kështu komunitetet lokale dhe duke reduktuar ndikimin mjedisor të zinxhirëve agro-ushqimor.

Tabela e përmbajtjes

1. PËMBLEDHJE EKZEKUTIVE 7

2. HYRJE 9

3. METODOLOGJIA 10

4. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR VENDIN DHE ZONAT RURALE 11

4.1 Sipërfaqja e përgjithshme dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore 11

4.2 Klasifikimi urbane-rurale (duke përfshirë përcaktimin e zonës rurale dhe sipërfaqen totale) 13

4.3 Statistikat demografike 14

4.4 Treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe kontributi i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit 14

5. ANALIZA E PROBLEMIT 16

5.1 Bujqësia dhe industria e ushqimit 16

5.1.1 Qëndrueshmëria e fermës 16

5.1.2 Konkurrueshmëria dhe orientimi i prodhimit kah kërkesat e tregut 19

5.2 Pozicioni i fermerëve në zinxhirin e vlerës 24

5.3 Toka bujqësore dhe resurset natyrore (tokat, pyjet dhe uji) 30

5.3.1 Ulja e ndryshimeve klimatike dhe përdorimi i energjisë se ripërtëritshme 30

5.3.2 Menaxhimi i burimeve natyrore si uji, toka dhe ajri 32

5.3.3 Biodiversiteti, shërbimet e ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve 34

5.4 Zonat rurale dhe infrastruktura socio-ekonomike 39

5.4.1 Punësimi, përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal në zonat rurale 39

5.4.2 Zhvillimi lokal 43

5.4.3 Ushqimi i shëndetshëm dhe siguria ushqimore 43

5.4.4 Barazia gjinore dhe përfshirja sociale 44

6. LIDHJA E PROBLEMEVE TË IDENTIFIKUARA ME OBJEKTIVAT 47

6.1 Problemet kryesore të identifikuara – bujqësia dhe sektori agro-ushqimor 47

6.2 Problemet kryesore të identifikuara – toka bujqësore dhe burimet natyrore 48

6.3 Problemet kryesore të identifikuara – zonat rurale dhe infrastruktura socio-ekonomike 49

6.4 Problemet kryesore në nivel të institucioneve publike 50

7. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL 52

7.1 Objektivi Strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës 52

7.2 Objektivi Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore 52

7.3 Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i biznesit në zonat rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale 53

7.4 Objektivi Strategjik:Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase. 53

8. ANEKSET 56

8.1 NDARJA E BUXHETIT SIPAS OBJEKTIVAVE TË PËRGJITHSHME 56

8.2 INDIKATORËT 57

8.3 IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE DHE ARSYESHMËRIA NË KUADËR TË OBJEKTIVAVE TË PËRCAKTUARA 59
8.3.1 Identifikimi i nevojave – Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës 59
8.3.2 Identifikimi i nevojave - Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore (toka, pyjet dhe uji) 63
8.3.3 Identifikimi i nevojave - Mbështetja e bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe e infrastrukturës sociale..... 65
8.3.4 Identifikimi i nevojave - Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase 67
9. PLANI I VEPRIMIT 69
10. KOSTOJA 69
11. STRATEGJIA E NDËRHYRJES DHE PËRSHKRIMI I MEKANIZMIT TË NDËRHYRJEVE.....**70**
12. PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT 85

1. PËMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është vend kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit synon hapa të mëtejshëm drejt integrimit në BE. Politikat e vendit për bujqësi dhe zhvillim rural janë duke u përafruar gradualisht me Politikat e Përbashkëta Bujqësore (PPB) të BE, me qëllim që sektori agro-rural të jetë konkurrent në regjion dhe në Bashkimin Evropian.

Përkundër faktit që Kosova ka tokë pjellore bujqësore të cilësisë së lartë, fragmentimi i tokës, pajisjet dhe makineritë e vjetra dhe të pamjaftueshme bujqësore, infrastruktura e dobët bujqësore (p.sh. sistemet e ujitjes, rrugët bujqësore, etj.), inputet e shtrenjta, qasja e vështirë në financa po ndikon në produktivitetin e ulët për njësi pune vjetore në bujqësi në krahasim me vendet e BE-së dhe vendet fqinje. E **dominuar me ferma të vogla të pa modernizuara dhe me një konkurrencë të hapur** nga vendet e BE-së dhe të rajonit, konkurrueshmëria e ulët e bujqësisë në Kosovë **reflektohet drejtpërdrejt në një bilanc tregtar negativ, sidomos me vendet e BE-së**.

Përgatitja e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028 ka këto qëllime të ndërlidhura:

- Të sigurojë Qeverinë e Kosovës dhe në veçanti, Ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe palët e interesuara (fermerët, shoqatat e fermerëve, grupet e prodhuesve dhe përpunuesit si dhe banorët rurale) në një pikë referente shumëvjeçare - Strategjinë si mjet për zhvillimin e bujqësisë dhe zonat rurale të Kosovës.
- Të krijojë një bazë për hartimin e programeve operative në nivelin më të ulët hierarkik, në veçanti Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, po ashtu një pikë referente edhe për BE dhe Instrumentin e Para-Anëtarësimit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (IPARD), dhe donatorë të tjerë që e mbështesin sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Misioni ynë është të transformojë ekonominë agro-rurale, duke e bërë atë më gjithëpërfshirëse, produktive, elastike, të qëndrueshme dhe konkurrente në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.
Vizioni i SBZHR 2022 – 2028 është zhvillimi i sektorit agro–rural konkurrent dhe inovativ i bazuar në njohuri, teknologji dhe standarde moderne, duke ofruar produkte të cilësisë së lartë në tregun e brendshëm, të regjionit dhe BE-së, si dhe zhvillim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mjedisit, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi të jetës për banorët në zonat rurale.

Objektivat strategjike dhe specifike të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë përcaktuar përmes një analize të problemeve dhe shkaktarëve të tyre.

Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës

Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe fleksibiliteti për të rritur sigurinë ushqimore
Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave te tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe digjitalizim
Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës

Objektivi Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore

Objektivi specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen në ndryshime klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme
Objektivi specifik 2.2: Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe ajrit
Objektivi specifik 2.3: Mbështetje në mbrojtjen e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve

Objektivi Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale

Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve

Objektivi specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cenueshme

Objektivi Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase

Objektivi specifik 4.1: Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD

Objektivi specifik 4.3: Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III

Objektivi horizontal 4.4: Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive

Strategjia është përqendruar në çështjet specifike kombëtare që do të trajtohen nga llojet e ndërhyrjeve të ngjashme me PPB, duke e plotësuar edhe me masa tjera të politikës së tokës dhe ujitjes. Strategjia është përgatitur duke marrë parasysh veprimet mjedisore dhe klimatike të përfshira në Marrëveshjen e Gjelbër; respektivisht, në angazhimet e Agjendës së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor. Strategjia mbulon një kombinim realist, megjithëse ambicioz, të skemave mbështetëse për fermerët dhe aktorët tjerë rural si dhe reformat institucionale. Ndërhyrjet janë të tipit Shtylla I (subvencionet), Shtylla II (grantet-zhvillimi rural) të PPB, projekte kapitale ose infrastrukturore dhe reforma institucionale që synojnë ta funksionalizojnë më tej ministrinë drejt një administrate publike më efikase. Të gjitha ndërhyrjet publike për periudhën 2022 - 2028 duhet të zbatohen nëse përfshihen në këtë dokument. Strategjia do të zbatohet kryesisht përmes Programit Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, projekteve kapitale, IPA III dhe kontributit të donatorëve të tjerë, ndërsa MBPZHR mbetet me përgjegjësinë e konsolidimit të administratës publike përmes reformave të duhura. Në fund të vitit 2028, sektori agro-ushqimor, ekonomia dhe infrastruktura e zonave rurale dhe struktura administrative e ministrisë duhet të demonstrojnë një përparim të qëndrueshëm, i cili mbeti për t'u monitoruar dhe vlerësuar përmes një sërë treguesish të rezultateve.

Ministria propozon që Plani i Veprimit të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të finalizohet pasi të përgatitet Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili është në fazën finale, në mënyrë që të harmonizohen aktivitetet dhe të ketë një koherencë të veprimeve. PBZHR pritet të finalizohet në muajin shkurt 2022, dhe në të njëjtën kohë edhe Plani i Veprimit të SBZHR 2022-2028

2. HYRJE

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën e bujqësisë në bruto prodhimin vendor, si dhe potencialin e lartë të këtij sektori për t'u zhvilluar më tej dhe për të gjeneruar të ardhura dhe vende pune, politika e bujqësisë dhe zhvillimit rural është padyshim një element i rëndësishëm i politikës së përgjithshme të zhvillimit të vendit.

Bujqësia është një nga aktivitetet më të rëndësishme ekonomike në Kosovë, potenciali për zhvillimin e bujqësisë është ende i pashfrytëzuar. Duke krahasuar treguesit e produktivitetit dhe rentabilitetit, madhësinë e fermave, teknologjinë e vjetruar, intensitetin e prodhimit, shkallën e eksportit si dhe parametrat e tjerë, është e qartë se Kosova ka mbetur prapa në zhvillimin e bujqësisë në raport me vendet e regjionit më pak të zhvilluara, kurse hendeku më i madh është me Bashkimin Evropian. Procesi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në BE kërkon harmonizimin e rregulloreve dhe standardeve në bujqësi me rregulloret dhe standardet e Bashkimit Evropian. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duhet të kontribuojë në një përdorim më të mirë të burimeve në bujqësi, në të njëjtën kohë arritjen e një niveli më të lartë të konkurrueshmërisë së bujqësisë. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, gjithashtu do të sigurojë një mënyrë për përshtatje me rregulloret e Bashkimit Evropian dhe një harmonizim me Politikën e Përbashkët Bujqësore të Bashkimit Evropian.

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2022-2028 është hap drejt përafrimit me politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së.

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 -28 ndërlidhet me zbatimin e programit të Qeverisë 2021-25, dhe të dy dokumentet e kanë për qëllim zhvillimin e sektorit agro-rural dhe në veçanti e trajtojnë ngritjen e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor, menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, mbështetjen e bizneseve në zhvillimin e zonave rurale, sigurinë ushqimore dhe reformat e administratës.

Nga 17 objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), Agjenda 2030, pothuajse të gjitha ndërlidhen me objektivat e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: zhdukjen e varfërisë, arritjen e sigurisë në ushqyerje, përmirësimin e të ushqyerit dhe promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjitha moshat, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, nxitjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme, përmbledhëse dhe gjithëpërfshirëse, punësimi i plotë dhe produktiv, puna me dinjitet janë vetëm disa nga problemat e identifikuar që i trajton kjo strategji, kjo edhe për faktin që përveç prodhimtarisë bujqësore trajton edhe çështjet socio-ekonomike të zonave rurale.

Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës 2021-2023 e konsideron sektorin e bujqësisë si një nga "prioritetet kyçe" të adresuara në masën e reformës nr. 3: **Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë**: qëllimi kryesor i kësaj mase është krijimi i politikave të mirëfillta në sektorin e bujqësisë në rritjen e prodhimtarisë dhe ristrukturimin agro-rural, zhvillimin e sektorit agro-ushqimor përmes përmirësimit të aftësive konkurruese, inovacioneve dhe rritjes së prodhimtarisë, zgjerimin dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes.

Ndërkohë, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parashikon masa konkrete për të përmirësuar zbatimin e politikës së bujqësisë dhe zhvillimit rural, të cilat përmbajnë forcimin e Strukturës Operative të përfshirë në përgatitjen, menaxhimin dhe kontrollin e kësaj politike, si dhe strukturimin e sektorit agro-rural.

Marrëveshja e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor kërkon transformim afatgjatë të sektorit të bujqësisë, duke minimizuar ndikimin e tij negativ mjedisor dhe klimatik dhe duke ruajtur ushqimin e përballueshëm dhe të shëndetshëm për qytetarët e Kosovës dhe tregjet e eksportit. Ky transformim në mënyrë të pashmangshme do të ketë pasoja në modelin socio-ekonomik të zonave rurale në Kosovë, pasi bujqësia luan një rol mbizotërues në ekonomitë dhe mjetet e jetesës rurale. Paralelisht me ndryshimet në sektorin agro-ushqimor, është e rëndësishme të sigurohet një transformim i qëndrueshëm i zonave rurale, duke rritur atraktivitetin për jetë në këto zona. Strategjia e ardhshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2028 adreson një seri veprimesh mjedisore dhe klimatike të përfshira në Marrëveshjen e Gjelbër, 'gjelbërimin' e sektorit të bujqësisë, d.m.th. reduktimin e ndikimeve mjedisore duke garantuar sigurisë ushqimore.

3. METODOLOGJIA

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është dokumenti i parë strategjik i këtij lloji i përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Përgatitja e këtij dokumenti është në linjë me politikat strategjike të Bashkimit Evropian për Politikat e Përbashkëta bujqësore (PPB) 2021-27.

Për të siguruar një qasje të integruar dhe koordinim të afërt ndërministror, është themeluar Grupi Drejtues (GD) për përgatitjen e Strategjisë dhe Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028. GD përbëhej nga përfaqësues të të gjitha Departamenteve të Ministrisë, Instituti Bujqësor i Pejës, Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, Agjencia e Pylltarisë dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës.

Nga Ministria e linjës dhe Zyra e Kryeministrit pjesë e grupit ishin:

- Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM
- Ministria përgjegjëse e Financave dhe Transfereve
- Ministria përgjegjëse e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Ministria përgjegjëse e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Pjesëmarrës vëzhgues ishin:

- Përfaqësues të ZBE në Kosovë
- Përfaqësues i FAO dhe
- Përfaqësues i projektit ARDP

Grupi Drejtues ishte themeluar që të diskutojë dhe të marrë vendime strategjike gjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë dhe Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028. Për të diskutuar çështje teknike janë themeluar gjashtë grupe (nga ekspertë të jashtëm dhe shoqëria civile, OJQ-të e sektorit te Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e analizës SWOT, zhvillimin e objektivave të përgjithshëm dhe specifikë dhe identifikimin e nevojave) . Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për hartimin dhe koordinimin e aktiviteteve rreth përgatitjes se këtij dokumenti.

Përveç kësaj që u tha me lartë, përgatitjes së Strategjisë i ka paraprirë një analizë e pavarur sektoriale për sektorët kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimit rural, e cila është financuar nga zyra e BE-së në Kosovë:

- Sektori i bimëve/drithërat, prodhimi i pemëve dhe perimeve, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin
- Sektori i blegtorisë (mishi, qumësht, vezë) - prodhimi, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin, dhe
- Diversifikimi rural dhe zhvillimi i ekonomisë rurale, përfshirë marketingun në tërë zinxhirin, duke përfshirë edhe nivelin e arritjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të BE–së, si dhe përafrimi me marrëveshjen e Gjelbër të BE-së.

Meqenëse SBZHR ka veprim ndërsektorial, janë shtjelluar dhe analizuar edhe shumë dokumente të prodhuara nga Ministritë e tjera të ndërlidhura me sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR VENDIN DHE ZONAT RURALE

Republika e Kosovës ka një sipërfaqe prej 10,905.25 km². Gjendet në pjesën e Evropës juglindore, e kufizuar me Shqipërinë në jugperëndim, Malin e Zi në veriperëndim, Serbinë në verilindje dhe në jug me Maqedoninë.
Territori shtrihet brenda gjerësive gjeografike 41° 51’ e 43° 16’ (N), dhe brenda gjatësive gjeografike 19°59’ e 21°47’ (E). Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet me lartësi të ndryshme mbidetare. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë, në lartësinë 270 m mbi nivelin e detit, ndërsa ajo më e larta ndodhet në perëndim të Kosovës, në Gjeravicë – 2.656 m mbi nivelin e detit.
Në aspektin hidrografik, Kosova ndahet në pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Rrjedhat lumore të Kosovës derdhen në tre ujëmbledhës detarë: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje.
Klima e Republikës së Kosovës në pjesën më të madhe është kontinentale, duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë, me ndikime mesdhetare dhe kontinentale (temperatura mesatare brenda vendit luhatet nga +30°C në verë, në –10°C në dimër). Megjithatë, për shkak të ngritjeve të pabarabarta në disa pjesë të vendit, ka ndryshime në temperaturë dhe shpërndarje të reshjeve.

4.1. Sipërfaqja e përgjithshme dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Kosovë është e ndarë në këto kategori: tokë bujqësore e cila merr pjesë me 38.53%, pyje dhe toka pyjore 44.11%, tokë urbane 4.40% dhe të tjera 12.96%.
Sipas të dhënave të anketës bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore nuk ka pasur ndryshime të mëdha dhe ka qenë një trend i përafërt i shfrytëzimit për këtë periudhë kohore. Në vitin 2016, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte gjithsej 415,826 ha, kurse në vitin 2017 vërehet një rritje e lehtë, duke vazhduar me rritje edhe në vitin 2018, ku kjo sipërfaqe ishte 418,582 ha. Rritja e shfrytëzimit të tokës bujqësore vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha, ndërsa në vitin 2020 ishte 420,210 ha, ngjashëm me vitin 2019.
Sipërfaqe më të madhe të tokës së shfrytëzuar zënë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) që përbëjnë 51.7% të sipërfaqes së tërësishme të shfrytëzuar të tokës bujqësore dhe vërehet se nuk ka pasur ndryshime të theksuara. Në vitin 2020 kjo sipërfaqe ishte 217,102 ha, që paraqet një rënie për 0.4% në krahasim me vitin 2019.
Pas livadheve dhe kullosave, sipërfaqe më të madhe ashtu si edhe në vitet tjera, edhe në vitin 2020 zë kategoria e tokës së punueshme–ara, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,372 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (kulturë e parë) dhe e serrave (kulturë e parë).

Tabela 1 - Shfrytëzimi i tokës: sipërfaqja e tokës së përgjithshme bujqësore, pyjeve, tokave urbane dhe të tjera/ ha

Vitet	2016	2017	2018	2019	2020	Pjesëmarrja (%) - 2020
Sipërfaqja e përgjithshme	1,090,800	1,090,500	1,090,500	1,090,500	1,090,500	100%
Toka bujqësore, nga e cila:	**415,826**	**416,072**	**418,582**	**420,141**	**420,210**	**38.53**
Tokë e punueshme – ara	*187,223*	*186,954*	*188,359*	*188,365*	*188,372*	*44.8 %*
Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	*7,864*	*8,033*	*7,818*	*8,319*	*8,435*	-
Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	*457*	*467*	*468*	*518*	*547*	-
Kopshte	*6364*	*7,135*	*8,558*	*10,115*	*10,029*	*0.27 %*
Plantacione të pemëve*	*6,364*	*7,135*	*8,558*	*10,115*	*10,029*	*2.39 %*
Plantacione të vreshtave	*3,112*	*3,199*	*3,272*	*3,367*	*3,437*	*0.82 %*
Fidanishte	*196*	*159*	*109*	*111*	*137*	*0.03 %*
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	*218,808*	*218,314*	*218,152*	*217,932*	*217,102*	*51.67 %*
Pyje dhe toka pyjore	**481,000**	**481,000**	**481,000**	**481,000**	**481,000**	**44.11 %**
Tokë urbane	**48,000**	**48,000**	**48,000**	**48,000**	**48,000**	**4.40 %**
Të tjera	**145,103**	**144,540**	**142,047**	**140,488**	**141,291**	**12.96 %**

Burimi: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2021; Inventarizimi Nacional i Pyjeve 2012 (gjithsej toka pyjore dhe toka urbane) Sqarim* Të dhënat për plantacione të pemëve janë të rishikuara (janë përfshirë edhe trupat e shpërndarë të pemëve dhe ndryshon nga të dhënat e Raportit të Gjelbër për periudhën '16-'20*

4.2. Klasifikimi urban-rural (duke përfshirë përcaktimin e zonës rurale dhe sipërfaqen totale)

Aktualisht sipas ligjeve, ndarja administrative e Kosovës është bërë në nivel të 38 komunave dhe 1.469 vendbanimeve. Jo zyrtarisht, me qëllim të zhvillimit ekonomik rajonal, komunat janë të organizuara ekonomikisht në shtatë regjione ekonomike (që korrespondojnë me NUTS 3).

Tabela 2 - Ndarja administrative e Kosovës

Regjioni (që korrespondon me NUTS 3)*	Komunat (LAU 1)	Numri i vendbanimeve (LAU 2)	Sipërfaqja e përgjithshme (km^2)	Popullsia e përgjithshme 2020)
Prishtinë	Prishtine, Lipjan, Podujeve, Obiliq, F.Kosove, Graqanice, Gllogoc, Novoberde	296	2,439	497,431
Pejë	Peje, Deqan, Istog, Kline, Junik,	223	1,631	229,134
Prizren	Prizren, Dragash, Mamushe, Suhareke,	154	1,025	292,597
Gjilan	Gjilan, Kamenice, Viti, Partesh, Ranillug, Kllokot	166	1,209	161,144
Ferizaj	Ferizaj, Shtime, Kaqanik,Shterpce, Hani I Elezit	126	1,030	185,119
Mitrovicë	Mitrovice, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Zveqan	336	2,077	224,121
Gjakovë	Gjakove, Malisheve, Rahovec	168	1,224	208,642
Gjithsej	**38**	**1,469**	**10,635**	**1,798,188**

**Rajonet NUTS -3 në përgjithësi kanë një popullsi prej 150,000 deri në 800,000 banorë – Eurostat*

Metoda më e përdorur për të përcaktuar zonat rurale është metoda e OECD-së, sipas së cilës një zonë konsiderohet rurale nëse dendësia e popullsisë së saj është nën 150 banorë për km^2, ndërsa një komunitet konsiderohet urban nëse dendësia e popullsisë është mbi 150 banorë për km^2.

Përkufizimi i zonave rurale të përdorura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011 bazohet në nivel të vendbanimeve, të karakterizuara me dendësi të vogël të popullsisë dhe zakonisht ku shumica e tokës është bujqësore në krahasim me rrethinën. Kjo nënkupton që në Regjistrimin e Kosovës të vitit 2011 vendbanimi është përkufizuar si rural me vendim administrativ të komunës. Duke përdorur këtë demarkacion (caktim kufijsh) nga ASK, 1,028,963 ha (94.3%) njihen si zona rurale ku gjendet 62.0% e popullsisë (bazuar në 1,078,239 banorë sipas Regjistrimit të vitit 2011).
Madhësia e vendbanimeve është marrë si tregues i demarkacionit, për të përcaktuar zonat rurale që të pasqyrohet gjendja ekzistuese sa i përket zonave rurale në Kosovë nga perspektiva socio-ekonomike dhe njëkohësisht për të përdorur një qasje e cila është në pajtim me gjendjen e tanishme administrative.

Rezultat i këtij vendimi është që vendbanimet me popullsi prej mbi 30,000 banorë, d.m.th qytetet Prishtina, Prizreni, Gjilani, Peja, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjakova, klasifikohen si zona urbane, ndërsa pjesa tjetër e territorit të Kosovës konsiderohet si rurale për qëllime të PZHRB 2014- 2020. Sipas këtij përkufizimi, 98.8% (10,787.94 km^2) e territorit konsiderohet rurale dhe është shtëpi për 74.1% (1,286,554 banorë) të popullsisë (shih Tabela 3).

Zonat malore

Sipas praktikave të BE-së, për përkufizimin e zonave malore merren parasysh dy parametra: lartësia (lloji A) dhe lartësia dhe pjerrësia (lloji B). Për t'u krahasuar me demarkacionin e zonave rurale, si njësi bazike territoriale janë përzgjedhur zonat kadastrale. Si hap tjetër, për secilën zonë kadastrale është llogaritur lartësia mesatare. Zonat malore "Lloji A" janë përkufizuar si zona kadastrale me lartësi mesatare mbidetare mbi 700m dhe të gjitha vendbanimet që vendosen brenda këtyre zonave janë përcaktuar si zona malore.
Zonat malore që preken nga kombinimi i pjerrësisë dhe lartësisë mbidetare përkufizohen si zona me lartësi mesatare mbidetare prej mbi 600m dhe pjerrësisë mbi 10% në më shumë se 50% të sipërfaqes së zonës kadastrale. Zonat e tilla përcaktohen si zona malore "Lloji B".

4.3. Statistikat demografike

Kosova ka një popullsi prej 1,798,188 banorësh, me një nga profilet më të reja demografike në Evropë, me rreth 50% të popullsisë në moshën nën 25 vjeç. 28% e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare, ndërsa gati dy të tretat (65%) janë të moshës për punë (moshat 15-64). Banorët mbi 65 vjeç përfaqësojnë 7% të tërë popullsisë. Në kontrast, ky grup i moshës më të vjetër përbën 16% të popullsisë në Evropë.[1]

Tabela 3 - Popullsia zakonisht rezidente dhe ekonomitë familjare private

Popullsia e gjithmbarshme	**1,798,188**
Popullsia urbane (sipas përkufizimit të ASK-së)	661,586
Popullsia rurale (sipas përkufizimit të ASK-së)	1,078,239
Popullsia nën moshën 6 vjeçare	179,648
% e popullsisë në moshën 6 vjeç	*10.3%*
Popullsia mbi 65 vjeç	116,785
% e popullsisë mbi 65 vjeç	*6.7%*
Popullsi e moshës 75 vjeç	38,922
% e popullsisë mbi 75 vjeç	*2.2%*
Numri i ekonomive familjare private	297,090
Mesatarja e anëtarëve për ekonomi familjare private	5.9

Burimi: ASK Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011. Rishikimi ne 2020

4.4 Treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe kontribut i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit

Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare, që paraqet performancën e ekonomisë së një shteti për një periudhë kohore.
Bazuar në rezultatet e anketës së BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike, rrjedh se BPV me çmime aktuale në vitin 2020 ishte 6,771.6 mil.€, ndërsa në vitin 2019 ishte 7,056.2 mil.€. BPV për kokë banori ishte 3,772 € në vitin 2020, kurse në vitin 2019 ishte 3,959 €.

Kontributi i bujqësisë në BPV ka pësuar rënie nga 8.2% në vitin 2016 në 6.5 % në vitin 2018, e pasuar nga një rritje e dukshme prej 7.2% në vitin 2019, dhe stabilizim në 7.4% gjatë vitit 2020.
Me pjesëmarrje prej 7.4 % në BPV gjatë vitit 2020, sektori i bujqësisë është renditur në vendin e katërt të ekonomisë në përgjithësi.

[1] *ASK: Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011, botimi 2012*

Tabela 4: Treguesit kryesorë te zhvillimit ekonomik dhe kontributi i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Variation 2015 - 2020
Bruto Produkti Vendor (në'000)	5,674,422	6,037,273	6,356,456	6,671,522	7,056,172	6,771,601	**+22,33%**
BPV për kokë banori (€)	3,202	3,386	3,534	3,715	3,959	3,772	**+21,64%**
BPV (Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi /'000 €)	435,635	493,337	470,932	435,728	510,773	498,526	**-9,07%**
Kontributi i Bujqësisë be BPV(%)	**7.7**	**8.2**	**7.4**	**6.5**	**7,2**	**7.4**	**-25,24%**

Burimi: ASK, Bruto produkti vendor 2015-2020)

5. ANALIZA E PROBLEMIT

5.1 Bujqësia dhe industria e ushqimit

5.1.1 Qëndrueshmëria e fermës

Sa më e madhe që është ferma, aq më të larta janë të ardhurat për numër punëtorësh. **Bujqësia e Kosovës karakterizohet nga bujqësia e shkallës së vogël**. Pothuajse 70% e fermave me tokë të punueshme janë deri në 2 ha, dhe më shumë se 60% e tokës së punueshme është në pronësi të fermave me sipërfaqe deri në 5 ha.

Tabela 5 - Fermat dhe toka e punueshme sipas kategorisë së madhësisë, si përqindje e totalit

Madhësia e fermës (ha)	Numri i fermave	Fermat sipas kategorisë së madhësisë, si përqindje e totalit	Toka e punueshme sipas kategorisë në hektarë	Toka e punueshme sipas kategorisë së madhësisë, si përqindje e totalit
0 - 0.5	32,020	**69.71%**	5,929	**60.59%**
0.5 - 1.00	18,355		12,065	
1.00 - 2.00	23,022		30,123	
2.00 - 5.00	24,231	28.72	65,202	
5.00 - 10.00	6,013	1.57%	39,533	21.14%
10.00 - 20.00	1,203		16,013	18.27%
20.00 - 30.00	246		5,146	
Më shumë se 30	200		13,016	
Totali	105,289	100%	187,026	100%

Burimi: Llogaritjet bazuar në të dhënat e MBPZHR, 2020

Në pjesën më të madhe, bujqësia mbetet kryesisht si veprimtari tradicionale që mbijeton në mungesë të burimeve tjera të të ardhurave dhe pa mjetet e duhura për modernizim. Nga studimet sektoriale të përgatitura për sektorët bujqësorë të Kosovës në vitin 2021, niveli i të ardhurave të fermave të nevojshme për t'i mbajtur ato si të qëndrueshme dhe fleksibile, vlerësohet të jetë si në tabelën e mëposhtme

Tabela 6 - Vlera e shtuar neto e Kosovës në krahasim me disa vende të BE–së

Vendet	Vlera e shtuar neto për njësi vjetore të punës	Vlera e shtuar neto e Kosovës në krahasim me disa vende të BE-së
Estonia	17,697	8.07%
Austria	28,481	5.01%
Hungaria	23,465	6.09%
Italia	34,198	4.18%
Bullgaria	14,667	9.74%
Polonia	7,269	19.65%
Sllovenia	6,336	22.54%
Kroacia	8,117	17.59%
Rumania	9,248	15.44%
Kosova	1,428	-

Burimi: Llogaritjet bazuar në FADN - Të dhënat e Komisionit Evropian dhe FADN, të dhënat e DAESB-MBPZHR, 2020

Tabela 7 - Pragjet e fermave-prodhimit të qëndrueshëm (viabilitetit)

Sektori	Pragjet
1. Lopë qumështore	15 lopë
2. Dele	130 dele
3. Dhi	130 dhi
4. Gjedhë	10 gjedhë
5. Pula vojëse	5 000 pula vojëse
6. Zogj	5 000 zogj mishi
Përpunimi	
1. Përpunimi i qumështit	2 000l/ditë
2. Thertore e gjedhëve (bagëtisë)	10 gjedhë/ditë
3. Thertore e zogjve	1 000 zog mishi/ditë

Burimi: Studimi i Sektorit të Blegtorisë, 2021

Krahasimet në mes të ardhurave bujqësore dhe jobujqësore janë të vështira dhe jo të thjeshta për t'u bërë, por pa të ardhura minimale, fermat janë në rrezik për vazhdimin e aktivitetit të tyre dhe kjo ka gjasa të nxisë emigrimin, sidomos të brezit të ri. Sidoqoftë, kjo vlerë shumë e ulët duhet parë nga perspektiva e alternativave të kufizuara ekonomike vendore dhe nivelit të ulët të pagesave direkte. Duhet të theksohet se roli i këtij lloji të mbështetjes së të ardhurave është jashtëzakonisht i rëndësishëm për Kosovën, pasi është nënshkruese e marrëveshjes për tregti të lirë (CEFTA dhe MSA me BE-së), por ende nuk ka një bujqësi konkurruese të modernizuar. Pagesat direkte ende nuk bëhen për tokë bujqësore, por për kultura bujqësore dhe kafshë, duke mbuluar kulturat më të rëndësishme bujqësore të kultivuara dhe sistemet e mbarështimit. Megjithatë, për sa i përket sipërfaqeve të kultivuara dhe numrit të kafshëve me mbështetje të të ardhurave nga pagesat direkte, mund të vlerësohet se **pagesat direkte mbulojnë vetëm rreth 50% të sipërfaqes me kultura kryesore bujqësore** (me fjalë të tjera, duke lënë pa mbështetje pothuajse gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme), ndërsa në rastin e kafshëve, përqindja është rreth 75% për lopët qumështore dhe delet.

Tabela 8 – Sipërfaqet që marrin pagesa direkte për disa kultura bujqësore, në krahasim me sipërfaqet totale të kultivuara, 2019

Kultura bujqësore	Sipërfaqet që marrin pagesa direkte (ha)	Sipërfaqja totale e kultivuar (ha)	Përqindja e sipërfaqeve të mbuluara me pagesa direkte
Gruri	35,287	80,273	43.96%
Misër	27,483	39,441	69.68%
Elb	488	1,954	24.97%
Thekër	196	420	46.67%
Perime (pa patatet)	8,295	13,952	59.45%
Pemishte	4,142	9,479	43.70%
Vreshta	2,989	3,367	88.77%

Burimi: Llogaritjet bazuar në Raportin e Gjelbër 2020 dhe të dhënat e AZHB

Sa i përket **nivelit të pagesave direkte** (p.sh., 100 - 150 euro për kultura bujqësore, 70 euro për lopë qumështore, 15 euro për dele apo dhi), **nëse krahasohen me BE, mund të konsiderohen shumë të ulëta**. Megjithatë, u dëshmua si shumë e dobishme për skemën e cilësisë së qumështit, e cila jo vetëm që konsolidon të ardhurat e fermave, por është gjithashtu e orientuar drejt rezultateve, duke nxitur zhvillimin e sektorit.

Tabela 9 - Numri i kafshëve që marrin pagesa direkte në krahasim me numrin e përgjithshëm të kafshëve, 2019

Kafshët	Numri i kafshëve që marrin pagesa direkte (krerë)	Numri i përgjithshëm i kafshëve (krerë)	Përqindja e kafshëve të mbuluara me pagesa direkte
Lopë mjelëse	62.478	80,273	77.83%
Dele dhe dhi	160,768	216,299	74.33%
Shpezë	1,181,829	2,665,262	44.34%
Derra	1,405	40,533	3,47%

Burimi - Llogaritjet bazuar në studimin sektorial për blegtorinë, 2021 dhe të dhënat e AZHB

Për më tepër, Kosova ka përcaktuar zonat malore (si zona me kufizime natyrore), por **nuk ka asnjë skemë pagese për të kompensuar humbjen e të ardhurave dhe kostove shtesë për shkak të handikapit natyror**. **Pagesat kompensuese gjithashtu mungojnë** për agro-mjedisin dhe për racat vendore, pavarësisht se kanë potencialin për të siguruar një vazhdimësi të traditës së gjatë të bujqësisë, që dëshmojnë qëndrueshmëri jo vetëm përballë kushteve natyrore, por edhe ndaj shumë sistemeve ekonomike dhe politike.

Një qëndrueshmëri absolute e fermës për të gjithë fermerët nuk është realisht e mundur. Fuqia punëtore më e vogël në bujqësi nënkupton që të ardhurat bujqësore ndahen mes më pak njerëzve, duke rritur kështu shumën për person. Produktiviteti më i lartë i punës dhe specializimi drejt prodhimit intensiv dhe me vlerë të lartë lidhen gjithashtu drejtpërdrejt me të ardhurat e fermave, dhe bujqësia e Kosovës është vetëm në fillim të kësaj rruge. Në rrugën e saj drejt modernizimit, Kosovës do t'i duhet të lirojë fuqinë punëtore, ndërsa një pjesë e rëndësishme e fermave të vogla do të bashkohen. Sfida është të mbahet një **ekuilibër të mirë midis mbështetjes së traditave dhe lehtësimit të modernizimit**, përndryshe rreziku i braktisjes së tokës, të paktën në zonat e thella malore, mbetet shumë i lartë, duke nxitur më tej migrimin, sidomos përmes shpërnguljes së brezit të ri, ndërsa traditat e vlefshme mund të shuhen.

Qëndrueshmëria e fermave gjithashtu kërkon miratimin e praktikave moderne bujqësore me fokus në ruajtjen e ujit dhe mbrojtjen e tokës - të nevojshme veçanërisht për tokat e ultësirave për fermerët më të mëdhenj. Praktikat e menaxhimit të qëndrueshëm të bujqësisë, si ato pa-lërim, lërim në formë vijash (veçanërisht në shpate), rotacioni i kulturave bujqësore me kultura foragjere-bishtajore, mbjellja e pyjeve dhe sipërfaqeve drusore (përfshirë brezat agro-pyjorë dhe karakteristikat e peizazhit drusor) dhe investimet në teknologjitë e reja. Aktivitetet trajnuese dhe këshilluese për fermer aktualisht zbatohen dobët në Kosovë.

Ujitja nuk i shërben vetëm qëllimit të rritjes së prodhimit dhe konkurrueshmërisë së fermave, por gjithashtu sigurimit të të ardhurave bujqësore gjatë viteve me thatësira. **Rreziku kryesor për qëndrueshmërinë e fermës ndërlidhet me sasinë e ujit në dispozicion**, e cila pritet të ulet gjatë viteve të ardhshme, ndërsa temperaturat gjatë stinës së verës të rriten. *Bazuar në parashikimet e modelit, ndryshimi i klimës do të ndikojë në mënyrë të ndryshme në digat kryesore të akumulimit të ujit në Kosovë. Në vitet me dimra të pasur me të reshura, vlera mesatare vjetore e ujit në dispozicion për person mund të rritet për lumenjtë Drini i Bardhë dhe Ibër, por më pak ujë për lumin Morava e Binçës. Sidoqoftë, shqetësimet kryesore jepen nga rritja e parashikuar e temperaturës në verë (+ 2.5 ° c) dhe ulja e reshjeve në pranverë dhe verë (-10%)* [21]. Master Plani për Ujitjen në Kosovë po tregon se **aktualisht ujiten vetëm 20,000 ha, nga një sipërfaqe prej 280,000 ha që ka potencial për zhvillimin e sistemit të ujitjes**.

Për më tepër, vijueshmëria dhe qëndrueshmëria financiare mund të mbështeten me **skema më të zhvilluara të sigurimeve bujqësore**, të cilat duhet të mbulojnë rreziqet më të rëndësishme në bujqësi, siç janë ngjarjet ekstreme meteorologjike (stuhitë, erërat e forta, breshëri, ngricat e vona në pranverë/fillim të vjeshtës, thatësirë, etj.), por megjithatë, Kosova ka në treg skema të kufizuara të sigurimeve bujqësore.

2 Master Plani për Ujtije në Kosovë, 2020

5.1.2 Konkurrueshmëria dhe orientimi i prodhimit sipas kërkesave të tregut

E dominuar nga fermat e **vogla të pa modernizuara, dhe me konkurrencë të hapur** nga vendet regjionale dhe të BE-së, konkurrueshmëria e ulët e bujqësisë në Kosovë pasqyrohet drejtpërdrejt në rritjen e **bilancit tregtar**, posaçërisht me vendet e BE. Gjithsesi, duhet theksuar se bilanci negativ tregtar është shkaktuar nga rritja e importeve me një ritëm më të lartë se eksportet, megjithatë duhet theksuar se disa kanale tregtare janë duke u konsoliduar.

Tabela 10 - Bilanci tregtar, Kosova kundrejt të gjitha vendeve, 2015 – 2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Eksportet	41.7	45.2	61.3	64	65.5	78
Importet	633.7	658.7	694.5	712.3	759.4	765.3
Bilanci tregtar	-592	-613.5	-633.2	-648.3	-693.9	-687.2

Burimi: Llogaritja bazuar në të dhënat e ASK-së

Prandaj, bujqësia e Kosovës është në **një proces të riorientimit drejt kërkesave të tregut dhe kulturave me vlerë të shtuar**: sipërfaqja e përgjithshme për drithëra është duke u zvogëluar, ndërsa për perimet, kulturat foragjere, pemishtet dhe vreshtat po rritet.

Dobësia kryesore në përmirësimin e efikasitetit të fermave është madhësia e sipërfaqes; fermat e vogla çojnë në fitim të pamjaftueshëm për të investuar. Kosova ka tokë bujqësore të cilësisë së lartë (83% e tokës bujqësore është e kategorisë 1 - 4, që do të thotë toka me pjellori të lartë). Investimi bazë për fermerët e vegjël duhet të jetë blerja e tokës bujqësore shtesë. Ndërsa shitja totale të tokës bujqësore nga AKP prej vitit 2005-2020 është 30,810 ha, do të thotë që 7.3 % e tokës bujqësore të shfrytëzueshme punueshme të vendit është transferuar ne sektorin privat qe ndikon drejt konsolidimit të strukturës dhe rritjes së fermës. Megjithatë, **pa një politikë të qartë për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe kontrolle të detyruara**, ndryshimi ilegal i përdorimit të tokës, i lidhur me ndërtimet ilegale në tokën bujqësore, është një kërcënim i madh ndaj arritjes së qëllimit të konsolidimit të tokës. Aq më shumë, për shkak të mungesës së politikave dhe legjislacionit të qartë për menaxhim të qëndrueshëm të tokës bujqësore.

Sa i përket **prodhimtarisë bujqësore, ndryshimi nga viti në vit është shumë i lartë, duke dëshmuar se nuk janë zbatuar hapa të rëndësishëm drejt modernizimit**, si dhe në uljen e nivelit të lartë të varësisë së bujqësisë nga kushtet klimatike. Përveç drithërave dhe kulturave foragjere, prodhimtaria për hektar është zvogëluar. Pjesërisht, rënia e prodhimtarisë për hektar në rastin e pemishteve dhe vreshtave mund të justifikohet edhe nga plantacionet e reja, të cilat hyjnë në prodhimtari vetëm gradualisht/

Tabela 11 - Prodhimi i kulturave bujqësore gjatë periudhës 2015 – 2019

Kultura bujqësore		2015	2016	2017	2018	2019	2020
Drithërat	ha	134,886	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714
	ton	443,584	562,899	477,880	441.757	459,404	529,112
	t/ha	3.28	4.18	3.95	3.56	3.69	4.24
Perimet	ha	14,656	17,395	19,643	17,886	18,911	19,243
	ton	246,096	335,467	358,394	265,420	300,557	290,555
	t/ha	16.79	19.28	18.24	14.83	15.89	15.09
Kulturat foragjere	ha	97183	97936	105613	107099	108480	108,436
	ton	317,888	390,707	486,989	480,966	504,406	503,758
	t/ha	3.27	3.98	4.61	4.49	4.64	4.64
Pemishtet	ha	4,930	5,668	6,422	7,922	9,479	10,265
	ton	44,674	54,836	34,207	53,606	67,294	72,265
	t/ha	9.06	9.67	5.32	6.76	7.09	7.03
Vreshtat	ha	3,068	3,117	3,199	3,272	3,367	3,437
	ton	25,422	23,666	15,364	27,322	19,318	26,330
	t/ha	8.28	7.59	4.80	8.35	5.73	7.66

Përdorimi i duhur i inputeve lidhet drejtpërdrejt me nivelin e prodhimit. **Niveli i plehrave dhe pesticideve është i pamjaftueshëm dhe përdorimi i tyre është joadekuat – nxirret si përfundim nga studimi sektorial për kulturat bujqësore, i përgatitur për Kosovën në vitin 2021. Kjo do të thotë se ka shumë hapësirë për rritjen e efikasitetit në përdorimin e plehrave dhe pesticideve, por kjo kërkon njohuri, analiza të tokës, makineri dhe trajnime. Cilësia e plehrave dhe pesticideve konsiderohet se është e ulët, dhe mungon zbatimi i një sistemi shtetëror të kontrollit për të verifikuar përqendrimin e substancave aktive.**

Menaxhimi i plehut organik është gjithashtu shumë i dobët, ku hendeku kryesor është **mungesa e magazinimit të duhur**, që çon në rrjedhje të lëndëve ushqyese dhe emetime të amoniakut, pra ndotje të ujit dhe ajrit me përbërës të azotit (në vend që të mbahet sa më shumë azot në plehun e kompostuar). **Nuk ekziston një Kod i Praktikave të Mira Bujqësore**, i cili promovon praktika të mira për ruajtjen dhe kompostimin e plehut organik dhe aplikimin e plehrave organikë dhe kimikë. Për disa sektorë, cilësia e ulët e materialit të mbjelljes (veçanërisht në rastin e rrushit, pemishteve, pemë të imta (dredhëza, mjedra, etj.) pengojnë rritjen e produktivitetit.

Sa i përket ujitjes, hendeku midis zonave të ujitura (20,000 ha) dhe zonave potenciale të ujitura (280,000 ha) është shumë i madh, **që dëshmon se kërkohen investime të konsiderueshme**, duke filluar me studimet e fizibilitetit për investimet e nevojshme kapitale për modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës primare të ujitjes. Projektet e integruara që përfshijnë Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (SHPU) mungojnë. SHPU-të ende nuk kanë njohuri të mjaftueshme, nuk janë të organizuara dhe të motivuara për të menaxhuar si duhet në mënyrë të përbashkët sistemin e ujitjes, megjithëse, për të siguruar qëndrueshmërinë e investimeve, këto shoqata duhet të jenë forcë shtytëse më e rëndësishme në procesin e modernizimit dhe rehabilitimit.

Për të pasur prodhimtari dhe produktivitet të shtuar, ujitjet në nivel fermash janë të domosdoshme sidomos për disa sektorë (p.sh., pemët dhe perimet).

Master Plani për Ujitjen, i përgatitur nga Banka Botërore në vitin 2020, përfshin rekomandime të vlefshme, por që ende nuk janë të përfshira në mekanizmin e financimit të administratës publike.

Produktiviteti është i lidhur ngushtë edhe me nivelin e mekanizimit. **Pajisja e dobët me makineri dhe makineria e vjetërsuar janë kryesisht pengesa në rritjen e produktivitetit të punës**. Sipas Regjistrimit të Ekonomive Bujqësore në Republikën e Kosovës, 2014, vetëm çdo e dyta fermë bujqësore posedon traktor, dhe shumica e traktorëve janë traktorë me një bosht tërheqës (87%), dhe më shumë se 73% e të gjithë traktorëve në pronësi të fermave bujqësore dhe kanë qenë më të vjetër se 20 vjet. Vlen gjithashtu të merret parasysh që makineritë e reja do të sjellin sfida të reja, siç është nevoja për trajnime të specializuara për përdoruesit dhe shërbimet/serviset e riparimit. Fatkeqësisht, nga të gjitha inputet bujqësore, çmimet e traktorëve tregojnë rritjen më të lartë prej 19% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2015. Për fermat e vogla, kostot për blerjen dhe mirëmbajtjen e makinerive janë të paarritshme, duke e bërë **strukturën e fermës pengesën më të madhe gjatë procesit të modernizimit**.
Çmimi i pesticideve është rritur paksa në pese vitet e fundit, ndërsa për plehrat është ulur pak. Megjithatë, **çmimet konsiderohen të larta, vështirë të përballueshme, dhe si pasojë përdoren nën nivelin optimal. Pa një kontroll të duhur të substancave aktive, cilësia e inputeve kimike konsiderohet e diskutueshme**.

Në rastin e **blegtorisë, përveç shpezëtarisë (me një rritje të kufizuar), ka shënuar një rënie të lehtë**. Siç përshkruhet në studimin sektorial për blegtorinë, të përgatitur në vitin 2021, ka shumë arsye për këtë: potenciali i dobët gjenetik i racave të përdorura, fermat e pa modernizuara, menaxhimi joefikas i fermës, si dhe fermerët e vjetër të përfshirë në mbarështimin tradicional, që nuk po zëvendësohen nga brezi i ri.

Tabela 12 - Blegtoria gjatë periudhës 2015 – 2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bagëtia	258,504	264,971	259,729	258,662	257,733	261,389
Delet dhe dhitë	224,096	212,040	210,688	209,808	216,299	241,688
Derrat	44,149	42,309	41,086	40,164	40,533	45,394
Shpezët	2,576	2,740	2,811	2,538	2,665	2,782

Burimi: Llogaritja bazuar në të dhënat nga Bujqësia e Kosovës në Shifra, 2021; ASK 2020

Pavarësisht se ekziston një potencial i mirë, sidomos në rastin e mbarështimit ekstensiv të deleve, eksporti i kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore është i bllokuar për shkak të **sistemit të dobët të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve,** dhe pa e zgjidhur këtë çështje administrative, perspektiva e zhvillimit të sektorit blegtoral mbetet e bllokuar.

Edhe pse rendimentet janë kryesisht me një trend të lehtë negativ**, me avantazhin e çmimeve më të larta për pothuajse të gjitha produktet bujqësore, prodhimi në bujqësi është rritur** në vitin 2020 në krahasim me vitin 2015, si për kulturat bujqësore, ashtu edhe për blegtorinë, duke i dhënë perspektivën e një biznesi fitimprurës.

Tabela 13 - Prodhimi i bujqësisë sipas çmimeve aktuale

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Produkti i kulturave bujqësore (mil. Euro)	350.17	412.13	402.5	388.3	441	477.4
Blegtori (mil. Euro)	120.3	160.5	157.4	140.3	167.7	164.2

Burimi: ASK, Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë

Si pasojë, **sektori privat po zgjerohet gradualisht**. Numri i bizneseve të reja, të punëtorëve në fermat e regjistruara dhe vlera në rritje e të ardhurave tregon se bujqësia është ende tërheqëse.

Tabela 14 - Bizneset aktive në bujqësi

Year	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i bizneseve aktive	2,130	2,314	2,398	2,942	2,405	2,780
Numri i punëtorëve	8,790	10,024	10,449	13,156	12,467	14,996
Të ardhurat (`000)	323,370	360,536	432,301	461,626	499,821	526,980

Burimi: ASK, Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë

Ky trend mund të mbahet për të ardhmen vetëm me investime të mëdha në ristrukturimin dhe modernizimin e fermave, në veçanti për kategorinë e fermave të mesme, me potencial për zgjerimin e biznesit. Megjithatë, në Kosovë **mungon dallimi i qartë mes asaj se cilat janë ferma të vogla, të mesme dhe të mëdha**, duke e bërë kështu të vështirë formulimin dhe zbatimin e politikave.

Përdorimi efikas i fuqisë punëtore është gjithashtu faktor kyç për konkurrencën. Numri i përgjithshëm i të punësuarve të regjistruar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari është rreth 19,700 persona, meshkuj 15,100 dhe 4,500 gra.[4] Sipas Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore të vitit 2019, popullsia e përgjithshme që punon në bujqësi është 270,181, ekuivalente me 82,657 NJVP (Njësia Vjetore e Punës).

Fakti që fermat kanë kapacitet të kufizuar për të transformuar inputet në outpute me vlerë të shtuar tregohet nga **vlera shumë e ulët neto e shtuar për NJVP, që është vetëm 1,428 euro.** Situata

më e rëndë është tek fermat më të vogla, pasi "*nuk duket se janë në gjendje të bëhen efikase në shkallë dhe të përfitojnë nga kthimet në shkallë ... janë të bllokuara në varfëri dhe ekonomia jobujqësore nuk ka kapacitet për të absorbuar tepricën e punës nga bujqësia*".[5]
Anketa e Fuqisë Punëtore për TM4 të vitit 2020 thekson që 31.8% e të papunëve në Kosovë janë të rinj (të moshave 15-24 vjeç). **Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (49.9%) dhe papunësia e të rinjve është më e lartë tek femrat (53.7%), në krahasim me meshkujt (48.0%). Megjithatë, shpresat për modernizim qëndrojnë tek të rinjtë.** MBPZHR ka inkurajuar fermerët e rinj përmes sistemit të vlerësimit (poentimit) të granteve.

Tabela 15 - Pjesa e fermerëve të rinj si përfitues të granteve

Indikatorët	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Përfituesit e ri - për të gjitha masat (%)	62.83	69.43	68.00	63.46	n/a	71.49

IBurimi: MBPZHR

Me qëllim të rritjes së produktivitetit të tokës, konsumi i ndërmjetëm do të rritet gjithashtu (për shkak të kostove shtesë të energjisë, plehrave, pesticideve etj.), duke rritur nevojën e kredive për prodhim. Me gjithë faktin se shuma e shpërndarë e agro-kredive kaloi 100 milionë euro për herë të parë në 2019, vlera është skajshmërisht e pamjaftueshme për nevojat e sektorit. **Qasja në financa mbetet e vështirë,** pasi niveli i kolateralit është vështirë i përballueshëm dhe normat e interesit mbetën shumë të larta (midis 6 dhe 30%), veçanërisht për fermat e vogla të menaxhuara nga të rinjtë.

Konkurrueshmëria ka të bëjë edhe me ofrimin e produkteve me cilësi të lartë. **Depot (me pajisje për klasifikim dhe paketim) dhe veçanërisht depot e ftohta (që mund të mbështesin eksportin me çmime më të larta në tregun e BE-së) janë të pamjaftueshme për të gjitha llojet e produkteve bujqësore. Për më tepër, linjat e përpunimit, pavarësisht se në përgjithësi kanë kapacitete të mjaftueshme përpunuese, kërkojnë investime shtesë për rritjen e cilësisë së prodhimit dhe sigurimin e standardeve të sigurisë ushqimore.** Standardet e cilësisë dhe sigurisë, të tilla si Global GAP, Emërtimi i Mbrojtur i Origjinës (PDO) dhe Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur (PGI) dhe bujqësia organike janë zbatuar dobët.
Sa i përket HACCP, megjithëse nuk është standard i detyrueshëm në BE, por parimet e HACCP janë të detyrueshme.
Bazuar në shkallën e rrezikshmërisë të sigurisë së ushqimit ndërmarrjet e përpunimit dhe paketimit të ushqimit me origjine shtazore, sipas Agjencisë se Ushqimit dhe Veterinës janë ndare në 4 kategori:

- Kategoria "A"= shkallë e ulët e rrezikut
- Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut
- Kategoria "C"= shkallë e lartë e rrezikut
- Kategoria "D"= shkallë shumë e lartë e rrezikut[6]. Vetëm një kompani nga sektori i kafshëve është e certifikuar për eksport në BE.

Shumica e standardeve nuk lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e produkteve, siç janë standardet mjedisore dhe të mirëqenies së kafshëve dhe mund të konsiderohen investime joproduktive. **Kostot për të siguruar pajtueshmëri paraqesin rrezik që mund të zvogëlojë edhe më tej marzhat aktuale të ulëta të fitimit, duke vënë në rrezik nivelin e brishtë të konkurrueshmërisë së sektorit**. Këto kosto mbulojnë përpjekjet financiare për investimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur (p.sh. më shumë hapësirë për kafshët në stalla - përfshirë përmirësimin e kafazeve për pulat vojse, menaxhimin e plehut organik - përfshirë enët e magazinimit të papërshkueshme nga uji dhe pajisjet e specializuara për aplikim, etj.).

[4] *Anketa e Fuqisë Punëtore për TM4 2020, ASK, 2020*
[5] *Memorandumi i Kosovës për Rritjen e Produktivitetit Bujqësor, Banka Botërore, 2021*
[6] *Kategorizimi i sigurisë ushqimore i Agjencisë së Veterinarisë - https://auvk.rks-gov.net/sq/bizneset-e-aprovuara-per-ushqime-me-origjine-shtazore*

Pastaj, **vonimi i investimeve të tilla çon në kosto mjedisore që zakonisht janë më të shtrenjta dhe që dëmtojnë gjithashtu shëndetin e njeriut dhe do ta mbajnë bujqësinë e Kosovës larg të qenit gati me rregullat themelore të CAP: pajtueshmërinë me kushtet për të gjitha pagesat e sipërfaqes sipas CAP** (pagesat direkte, kompensimet për kufizimet natyrore, eko-skemat, skemat agro-mjedisore, etj.).
Sipas kornizës ligjore në fuqi, sistemi këshillimor publik është në përgjegjësinë e DSHK&T ne kuadër të Ministrisë, i cili po ashtu koordinon aktivitetet e Qendrave Komunale për Informim dhe Këshillim.
Me gjithë faktin se është relativisht i ri, sistemi këshillues privat konsiderohet më i madh se sistemi publik. Aktiviteti i tij ndërlidhet me tema të veçanta në interesin e fermerëve: inputet, qendrat e grumbullimit, përpunimi i agro- ushqimit, skemat e granteve. Trajnime të suksesshme mbi standardet e tregut u siguruan nga qendrat e grumbullimit dhe fabrikat e përpunimit të ushqimit, gjithashtu me ndihmën e donatorëve. Një organizatë vendore e konsoliduar me aktivitete horizontale të lidhura me bujqësinë dhe me përvojë të mirë në ofrimin e trajnimeve për fermerët është IADK-ja[7]; megjithatë, aktiviteti i saj është më tepër i orientuar drejt projekteve, dhe, si në rastin e mbështetjes së donatorëve, ngrihet çështja e qëndrueshmërisë afatgjate.
Koordinimi midis sistemit këshillues publik dhe atij privat është i dobët, ku një nga arsyet është mungesa e shoqatave të organizuara mirë të fermerëve që mund të përfshihen në transferimin e njohurive në dobi të anëtarëve të tyre. Sistemi këshillimor publik nuk ka kapacitet për të adresuar siç duhet nevojat e fermerëve, pasi mbështetet në buxhet të kufizuar dhe nuk ka sistem monitorimi dhe vlerësimi për aktivitetin e tij. Në të njëjtën kohë, sektori privat zakonisht lidhet me biznes specifik ose drejt ndihmës së fermerëve për të përfituar grante, ndërsa mungon sistem për akreditimin e ofruesve të këshillimit. **Universitetet dhe institutet kërkimore nuk janë të përfshira mjaftueshëm dhe nuk janë të orientuara drejt fermerëve, dhe koncepti i inovacionit në kuadër të transferimit të njohurive mungon në masë të madhe**. Sistemi këshillues nuk e ka në shënjestër kategorinë e fermerëve me potencialin më të lartë të aplikimit të njohurive të reja të fituara, siç janë fermerët e rinj, si dhe nuk i synon praktikat moderne bujqësore për mbrojtjen e dheut dhe ujit.
Duhen përpjekje për të menaxhuar periudhën e tranzicionit drejt adoptimit më të gjerë të teknologjive të reja, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në menaxhimin e njohurive. Disa hendeqe mund të pengojnë miratimin e teknologjive për rritjen e produktivitetit dhe kursimin e inputeve. Hendeku i njohurive mund të jetë pengesa më problematike në modernizimin e bujqësisë së Kosovës.

5.1.3 Pozicioni i fermerëve në zinxhirin e vlerës

Ekzistojnë asimetri të qarta të fuqisë negociuese përgjatë zinxhirëve të vlerave. **Fermerët në Kosovë kryesisht tregtojnë në çmimet e tregut**, pasi ata kanë pak fuqi negociuese në përcaktimin e çmimeve për inputet dhe prodhimin e tyre. Si tregtarët e inputit, edhe përpunuesit janë më mirë të organizuar dhe mund të imponojnë çmimet, të paktën në nivel lokal
Mungon baza ligjore specifike (e përafruar me BE) për organizatat e prodhuesve, dhe mungon skema e veçantë kombëtare e mbështetjes publike për të inkurajuar krijimin dhe aktivitetin e tyre fillestar. Pavarësisht proporcionit shumë të lartë të fermerëve të vegjël dhe mangësive të ndryshme në zinxhirin e vlerave, **dihet vetëm për disa shoqata të fermerëve.** Duket se **sektorët me kërkesë të lartë në treg, të tillë si pemët e imëta (mjedra, dredhëza dhe manaferrat), pemët dhe perimet, janë më të prirë për krijimin e/anëtarësimin në një organizatë të grupit të prodhuesve**.
Shumica e tyre ishin përkrahur nga donatorë ndërkombëtarë përmes projekteve të ndryshme. Sa i përket krijimit të kooperativave, dihen vetëm disa raste, shumica e të cilave u mbështetën me projekte të financuara nga donatorët.
Korniza ligjore aktuale nuk është e mjaftueshme për t'i rregulluar kooperativat, pasi kërkon posedim dhe përdorim të përbashkët të aseteve dhe kjo mund të mos funksionojë siç duhet pa rregulla të qarta për mbajtjen e kontabilitetit të fermave për aktivitetet e përbashkëta.

Pavarësisht tendencës së përqendrimit të lartë të kanaleve të vlerës në disa qendra grumbullimi dhe fabrika të përpunimit dhe më tej në disa zinxhirë të shitjes me pakicë muk ka shoqata nder profesionale (për sektor te ndryshëm bujqësor, për gjithë zinxhirin e mallrave), andaj nuk ekziston asnjë organ shoqërues që i bashkon fermerët, përpunuesit agro-ushqimor dhe përfaqësuesit e (hiper) maketeve, për t'u dhënë rast diskutimeve mbi marzhet e fitimit përgjatë zinxhirëve të vleres

Analiza SWOT Rritja e konkurrencës së sektorit agroushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë se prodhimit në fermë

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
Menaxhimi i tokës dhe ujitjes - Kushtet e mira agroklimatike për kultura të veçanta - Ekzistimi i bazës ligjore për mbrojtjen e tokës, ujitjen e tokave bujqësore dhe për planifikim hapësinor. - Ekzistimi i master planit për ujitje - Ekzistimi i planeve zhvillimore komunale	**Menaxhimi i tokës dhe ujitjes** - Toka bujqësore e fragmentuar në ngastra të vogla - Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore - Braktisja e aktiviteteve bujqësore - Mungesa e një politike të qartë për mbrojtën e tokës - Problem me pronësinë – mostransferimi i trashëgimisë (krijojnë problem në qiradhënie dhe qiramarrje afatgjatë si dhe hipoteka në bankë) - Ndotja e tokave bujqësore (përdorimi jo i drejtë i PMB-ve, plehrave kimike, ujrat e ndotura dhe mbeturinat). - Përdorimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe në toka bujqësore - Degradimi/enaxhimi i keq i lumenjve dhe shkatërrimi i shtretërve të lumenjve - Erozioni i tokës - Shkarkimi i ujërave të ndotura në trupa ujorë pa trajtim paraprak - Zbatimi i pamjaftueshëm i politikave dhe legjislacionit - Mungesa e njohurive të mjaftueshme të fermerëve për praktikat e mira të ujitjes - Mungesa e trajnimeve dhe shërbimit të specializuar këshillimor për çështjet e mjedisit - Mungesa e të dhënave GIS - Mungesa e menaxhimit të deponive
Bujqësia dhe industria e ushqimit - Traditë në prodhimin e pemëve, perimeve, rrushit si dhe të prodhimeve blegtorale - Trend në rritje të zhvillimit të fermave komerciale - Kullota të mjaftueshme për shfrytëzim - Baza ligjore për sigurinë e ushqimit - Kapacitete të mjaftueshme të industrisë agropërpunuese/Ndërmarrje të përpunimit të ushqimit që operojnë mirë - Disa nga përpunuesit e ushqimit (qumësht	***Bujqësia dhe industria e ushqimit*** - Mungesë e llojeve të ndryshme të produkteve të përpunuara (prodhime jo të diversifikuara) - Sasi e pamjaftueshme e prodhimit primar - Çmime të larta dhe cilësi e ulët e inputeve bujqësore (fara, ushqim i

dhe mish) përmbushin standardet e BE-së për siguri të ushqimit (kategoria A) - Trend i rritjes së kapaciteteve prodhuese - Rritja e kërkesës së konsumatorëve për prodhime vendore të freskëta - Përmirësimi i politikave dhe përkushtimit të Qeverisë për zhvillimin e aftësisë konkurruese të sektorit - Ekzistenca e strukturave bazike për këshillime dhe transfer të teknologjisë për prodhimin primar - Përmirësimi i njohurive (know-how) si për shkak të implementimit të projekteve të ndryshme të financuara nga donatorë - Buxheti kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural është rritur (pagesa direkte dhe grante investive) për sektorët kryesorë të agroushqimit - Kapacitet i MBPZHR-së në menaxhimin e Programit IPARD - Përmirësimi racor i popullatës së gjedhit	koncentruar, raca, plehrat) - Shumica e varieteteve dhe racave me rendiment të ulët - Mungesa e infrastrukturës bujqësore (ujitja, rrugët e arave) - Produktivitet i ulët i punës për shkak të mungesës së mekanizmit të vjetruar bujqësor, dhe objekte të vjetruara - Mungesa e dixhitalizimi në bujqësi dhe industri ushqimore - Mosmbajtja e shënimeve të kontabilitetit në fermë nga shumica e fermerëve - Kapacitet i kufizuar financiar për të investuar në teknologji të re - Niveli i ulët i bashkëpunimit vertikal dhe horizontal në mes të prodhimit dhe përpunimit - Organizata të dobëta të prodhuesve dhe mungesa e legjislacionit përkatës - Aftësi të dobëta të menaxhimit të fermës dhe mungesë e shërbimeve këshillimore gjithëpërfshirëse dhe trajnimeve të rregullta - Niveli i ulët i përkushtimit të institucioneve dhe fermerëve për përkrahjen e procesit të konsolidimit të tokës bujqësore - Organizim i dobët i tregut dhe mungesë e objekteve me teknologji moderne për trajtim pas vjeljes (qendra grumbulluese, depo) - Niveli i ulët i zbatimit të standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (siguria e ushqimit, mjedisi, mirëqenia e kafshëve) - Produktivitet i ulët i sektorit përpunues për shkak të teknologjisë së vjetruar - Shkallë e lartë e importit të prodhimeve agroushqimore dhe të prodhimeve gjysmëfinale - Treg joformal i prodhimeve bujqësore - Vështirësi për marrje të kredive bujqësore dhe kamata të larta, grejs periudhë e shkurtër dhe vetëm kredi me afat të shkurtër të kthimit - Skemat e sigurimeve vështirë të arritshme dhe të mangëta (nuk përfshihen të gjitha kulturat bujqësore) për fermerët - Përfshirje e ulët e hulumtimit dhe zhvillimit dhe ritëm i ngadalshëm i depërtimit të risive në sektorin e agroushqimit - Mungesa e investitorëve të jashtëm që

Edukim dhe Trajnim në Bujqësi dhe Zhvillim Rural

- Baza ligjore për trajnime dhe shërbime këshillimore e përfunduar. (Ligji numër 04/L-074 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me aktet nënligjore);
- Struktura organizative e shërbimeve këshilluese e themeluar. Krijimi i Departamentit të Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike (Vendimi i ZSP-769/12 dhe 38 Qendra këshilluese informative komunale) ;
- Përvojë në zbatimin e skemës mbështetëse për ofrimin e shërbimeve këshillimore dhe të trajnimeve profesionale për këshilltarë, fermerë dhe komunitetin rural;
- Sistemi për arsimim/hulumtim dhe aftësim profesional publik dhe privat i konsoliduar (5 shkolla të mesme bujqësore, 3 fakultete bujqësore profesionale dhe 13 kompani këshilluese private të licencuara);
- Avancimi i njohurive te fermerët dhe agropërpunuesit mbi standardet e cilësisë dhe të sigurisë së ushqimit (produkteve bujqësore);
- Ofrimi i shërbimeve këshillimore për fermerët pa pagesë (gratis);
- Përvoja të fituara nga praktikat e mira bujqësore të këshilltarëve bujqësorë dhe të fermerëve liderë, nga vizita studimore në BE.
- Potencial profesional dhe teknik të mjaftueshëm në sektorë të ndryshëm bujqësorë;
- Numër i konsideruar i këshilltarëve bujqësorë të trajnuar dhe të certifikuar (rreth 400 këshilltarë publik dhe privat të certifikuar);
- Gatishmëria e 38 QKIK dhe 43 këshilltarëve publik për bujqësi dhe zhvillim rural për bashkëpunim me DSHKT;
- Gatishmëri e studentëve të bujqësisë të diplomuar për të vazhduar trajnimet e tyre që të jenë të angazhuar në aktivitetet bujqësore dhe me QKIK;
- Mundësia që në baza vjetore, të mund të sjellin kapital dhe know-how
- Mungesa e ekspertëve (teknologëve me përvojë dhe të specializuar, ekspertëve të makinerisë etj.)
- Mungesë e njohurive dhe mundësive për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme nga prodhimet bujqësore
- Plakja e popullsisë që merret me bujqësi dhe mungesa e interesit dhe motivimit të të rinjve për ta konsideruar bujqësinë si profesionin e tyre kryesor
- Njohuritë, informacioni dhe aftësitë e pamjaftueshme për menaxhimin modern të fermës, standardet kombëtare dhe të BE-së; përmbushje e dobët e standardeve
- Interesim i ulët për të investuar në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike.
- Niveli i ulët i besimit në politikat publike kombëtare

Edukim dhe Trajnim në Bujqësi dhe Zhvillim Rural

- Struktura organizative e shërbimeve këshilluese jo plotësisht funksionale;
- Mungesa e një Komisioni Këshillues (me përbërje gjithëpërfshirëse: MBPZHR, MASHT, Fakulteti i Bujqësisë);
- Sektori privat dhe akterë të tjerë relevant për rekomandime dhe përgatitjen e programeve trajnuese të ekstensionit;
- Mungesa e mbështetjes politike në riorganizimin e DSHKT-së, deri në vitin 2020;
- Mungesë e Identifikimit të nevojave dhe përcaktimit të prioriteteve për kërkimin dhe transferimin e teknologjive, proces qe kërkon përmirësim te ndjeshëm;
- Mungesë e mbështetjes për QKIK-në, me logjistikën e nevojshme si dhe futjen në përdorim masiv të teknologjisë të informacionit dhe uebfaqen e shërbimeve këshilluese;
- Hezitimi i fermerëve për të pranuar inovacione - Dominimi i metodave tradicionale në bujqësi;
- Shumica e fermerëve nuk janë në linjë me zhvillimin modern të bujqësisë;
- Vështirësitë në përhapjen e informacionit për fermerët (Nuk ka një

organizohen trajnime në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale për këshilltarët bujqësorë publik dhe privat; - Ekzistojnë fermat modele, ku mund të kryhen praktika të mira bujqësore dhe demonstrime në fermë; - Qasje në fonde nacionale dhe fonde të BE-së.	qasje të mirë për fermerët në informata dhe këshilla), fermerët e rinj marrin informata për t'i plotësuar nevojat e tyre nga interneti; - Mos integrimi i plotë i QKIK-së dhe 43 këshilltareve komunal në MBPZHR-DSHKT; - Bashkëpunimi dhe koordinimi i pamjaftueshëm me institucione të ndërlidhura (departamente teknike, AZHB-në); - Niveli i pamjaftueshëm i trajnimit praktik dhe demonstrimeve; - Mungesa e vlerësimit të programeve për trajnime dhe shërbimeve këshilluese publike, si dhe mungesa e vlerësimit të trajnerëve; - Mungesa e një sistemi monitorues në DSHKT; - Përdorimi i kufizuar i medieve për publicitet dhe promovimin e aktiviteteve bujqësore; - Organizimi i dobët i fermerëve në Shoqata dhe Kooperativa; - Niveli i ulët i njohurive për mbajtjen e shënimeve në fermë/kontabilitetin e fermës dhe menaxhimin e fermave; - Vështirësi në zbatimin e plotë të Ligjit për shërbime këshilluese, nga ofruesit e shërbimeve këshilluese.

MUNDËSITË	RREZIQET
Menaxhimi i tokës dhe ujitjes - Trendi i rritjes së çmimeve bujqësore stimulon një përdorim racional të tokës bujqësore - Eksporti i produkteve të certifikuara organike dhe bimët mjekësore	**Menaxhimi i tokës dhe ujitjes** - Trajnimi i pamjaftueshëm për fermerët - Humbja e tokës nga ndërtimet e pakontrolluara - Humbja e cilësisë së tokës nga prodhimi intensiv - Ndotja e ujit - Erozioni i mëtejshëm i tokës - Ndryshimet klimatike, thatësira, përmbytjet - Kullosat e pashfrytëzuara sa duhet - Zbatimi i papërshtatshëm i certifikimit dhe kontrollit të sistemit organik - Konvertimi i livadheve në tokë të punueshme ose tokë jobujqësore
Bujqësia dhe industria e ushqimit - Preferenca e konsumatorit për produktet vendore - Rritja e të ardhurave të konsumatorëve çon në rritje të kërkesës në treg - Mbështetja nga donatorët e qëndrueshëm - Marrëveshja e MSA-së, qasja në tregjet e BE-së - Rritja e kërkesës për eksport të prodhimeve organike të certifikuara dhe bimëve mjekësore - Kërkesa e tregut për përdorimin e mbetjeve organike për prodhimin e bio-naftës.	**Bujqësia dhe industria e ushqimit** - Rritja e konkurrencës nga prodhimet e importit të subvencionuara shumë - Lëvizjet e paparashikueshme të çmimeve të prodhimeve bujqësore - Ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore - Rritja e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës nga operatorët ekonomik jobujqësorë - Emigrimi i popullsisë, sidomos i të rinjve nga zonat rurale - Vendosja e standardeve mjedisore pa mbështetjen e mjaftueshme publike mund të ndikojë negativisht në aftësinë konkurruese të fermave dhe industrisë agroushqimore - Kapaciteti i pamjaftueshëm institucional në zbatimin e pagesave direkte dhe skemave të granteve po e pengon sektorin nga qasja në burimet e disponueshme financiare.
Edukim dhe Trajnim në Bujqësi dhe Zhvillim Rural - Gatishmëria për bashkëpunim në të gjithë zinxhirin e vlerës në sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë për dije dhe transferim të inovacionit; - Gatishmërinë e Qeverise dhe donatorëve, përfshirë mbështetjen nga BE, përmes IPA III; për mbështetjen e shërbimeve këshilluese, me mbështetje financiare, në riorganizim, ekspertizë, shërbime	**Edukim dhe Trajnim në Bujqësi dhe Zhvillim Rural** - Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm qeveritar për funksionimin e qëndrueshëm të Shërbimeve Këshilluese; - Mungesa e një strategjie të duhur për sistemin e arsimit bujqësor (mungesa e një plani për vlerësimin e kurrikulave dhe doracakëve për shërbime të ekstensionit në bujqësi dhe zhvillim rural);

kështilluese, formim profesional dhe trajnime; - Bashkëpunim dhe koordinim më i mirë i aktiviteteve me ofrues/këshillues privat, me qellim të zgjerimit të disponueshmërisë së shërbimeve këshilluese në mbështetje të shërbimit pluralist këshillues, që mund të japin për fermerët dhe komunitetin rural; - Struktura e re politike në mbështetje të Departamentit të Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike;	- Mungesa e një strategjie të miratuar (brenda MBPZHR-së), për shërbime këshillimore; - Mungesë e koordinimit të aktiviteteve këshilluese trajnues në mes të institucioneve arsimore shkencore/hulumtuese, inovative dhe laboratorëve dhe institucioneve private këshilluese me MBPZHR; - Rreziku i perceptimit të shërbimeve këshilluese si të padobishme nga fermerët; - Migrimi i rinisë dhe njerëzve profesional drejt zonave urbane dhe jashtë vendit; - Mungesa e një organi certifikues/akreditues për licencimin e këshilltarëve bujqësorë; - Kapaciteti profesional i pamjaftueshëm administrativ në qendrat kërkimore dhe kompani private këshillëdhënëse; - Mungesa e kuadrove të specializuar në fushën e diverifikimit rural, ekstension, agromjedis dhe teknologji ushqimore. - Mosnivelizimi i pagave për këshilltarë komunal në QKIK ka shkaktuar demotivim të këshilltarëve në komuna; - Mungesa e vullnetit politik në ristrukturimin dhe organizimin e DSHKT-së, në një institucion arsimor, këshillues dhe hulumtues në funksion të një bujqësie të qëndrueshme; - Nuk ka një aftësim/edukim të vazhdueshëm për fermerë ekspertë (të gjithë janë të bazuar në tenderë) - Nuk ka mbështetje financiare dhe teknike për hulumtime dhe inovacione. - Perceptimi i të rinjve për bujqësinë si sektor pa perspektivë *(si atyre qe dëshirojnë të merren me bujqësi por edhe i atyre qe dëshirojnë ta studiojnë bujqësinë), që po rezulton* - Grumbullimi i të dhënave dhe informacioneve ne bujqësi është i vështirë.

5.2 Toka bujqësore dhe resurset natyrore (tokat, pyjet dhe uji)

Toka konsiderohet si aspekti më i rëndësishëm i prodhimit, veçanërisht prodhimit bujqësor. Pavarësisht nga përparimi i qytetërimit dhe zhvillimi i teknologjisë, problemi i prodhimit dhe furnizimit me ushqim varet nga kufizimeve dhe disponueshmërinë e tokës së punueshme.
Mbrojtja e tokës bujqësore mundëson siguri afatgjatë ushqimore dhe siguron përfitime thelbësore mjedisore. Promovimi i qëndrueshmërisë bujqësore ndihmon për të siguruar që toka bujqësore të kultivohet dhe të jetë në dispozicion për prodhimin e ushqimit në të ardhmen. Ekziston një pajtim i gjerë i rolit të fermerëve në zbutjen e ndryshimeve klimatike; ruajtjen e burimeve natyrore, peizazheve dhe biodiversitetit. Nga perspektiva e politikës bujqësore, Kosova sapo ka filluar t'i bëjë ndërhyrjet e saj sa më miqësore ndaj mjedisit, por praktikat tradicionale bujqësore të krijuara prej kohësh tashmë kanë sjellin përfitime mjedisore. Rezultati është një biodiversitet i pasur, peizazhe të bukura dhe produkte vendore me cilësi të lartë.

5.2.1 Ulja e ndikimit te ndryshimeve klimatike dhe përdorimi i energjisë se ripërtëritshme

Nuk ka të dhëna historike të hollësishme mbi klimën e Kosovës, por duke qenë një vend i vogël brenda Ballkanit Perëndimor, mund të konsiderohet se tendencat dhe parashikimet e saj klimatike janë të ngjashme me ato të rajonit. Kështu, sipas Profilit të Rrezikut të Ndryshimeve Klimatike për Kosovën [8] të përgatitur nga USAID, **vrojtimet në Ballkanin Perëndimor përfshijnë rritje të temperaturës që nga viti 1960, rënie të reshjeve dhe rritje të intensitetit dhe frekuencës së ekstremeve të reshjeve** (si shira të fuqishëm ashtu edhe thatësira), si dhe rritje të numrit të zjarreve pyjore gjatë 20 viteve të fundit. Parashikimet klimatike i referohen një vazhdimësie të klimës së nxehtë me një intensitet më të lartë se mesatarja botërore dhe një rënie të reshjeve të përgjithshme vjetore, me ulje më të mëdha në verë, por edhe një rënie të numrit të ditëve me mbulesë bore.
Sa i përket **emetimeve të GS-ve (gazrave serrë), në vitin 2018 pjesëmarrja e bujqësisë është rreth 6% nga emetimet e përgjithshme të vendit**[9], që është shumë më e ulët se ajo e BE-së (12.55%).[10] Vlera më e ulët vjen si pasojë e niveleve të larta të emetimeve në vend nga sektori i energjisë (përdorimi i thëngjillit për energji elektrike dhe ngrohje) dhe për shkak të numrit më të ulët të kafshëve/kryesisht menaxhimit ekstensiv të sektorit të mbarështimit të kafshëve.

Shumica e emetimeve me burime bujqësore janë nga fermentimi enterik (70%) dhe nga menaxhimi i plehut të kafshëve dhe menaxhimi i dheut (10%). Metani (CH_4) - me efekt ngrohjeje 25 herë më të lartë, ka një pjesëmarrje prej 75% në emetimet totale të GS-ve nga bujqësia, oksidi i azotit (N_2O), me efekt ngrohjeje 298 herë më të lartë, ka një pjesëmarrje prej 22%, ndërsa vetëm 3% të emetime të GS-ve janë CO_2.

Kosova nuk ka elaboruar parashikime për emetimet e GS-ve dhe nuk ka ende një periudhë referimi për reduktimet e mundshme, pasi ende nuk është pjesë e konventave ndërkombëtare. Duke synuar rritjen e bagëtisë së saj dhe duke marrë parasysh kapacitetin e sektorit për të gjeneruar fitim që do të riinvestohet, **për Kosovën është sfiduese ndjekja e objektivit të BE-së për reduktimin e emetimeve të GS-ve në 55% deri në vitin 2050**. Ndërsa zvogëlimi i emetimeve nga fermentimi enterik është i vështirë të zbatohet (p.sh., zvogëlimi i niveleve të proteinave në ushqimin e kafshëve) pasi ai do të zvogëlonte produktivitetin e fermave; **sektorit i mungojnë shtallat moderne, kontinierët e përshtatshëm për ruajtjen e plehut organik dhe pajisjet për aplikimin e plehut në terren**. Impiantet e biogazit mungojnë plotësisht në Kosovë, për shkak të arsyeve praktike: mungesës së fermave të mëdha të kafshëve dhe infrastrukturës së fermave të nevojshme për transport të shpejtë të plehut organik në impiant (përndryshe, metani humbet gjatë procesit të mineralizimit të plehut organik). Sa i përket energjisë së ripërtëritshme, Kosova mund të mbështetet në më shumë se 1.27 milionë tonë biomasë nga burimet pyjore dhe në 3.83 milionë tonë biomasë në vit për përmbushjen e objektivave të caktuar në Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Energjisë së Ripërtëritshme. Potenciali i përgjithshëm i sasisë vjetore të energjisë elektrike dhe energjisë termike nga biomasa pyjore dhe bujqësore vlerësohet në 7,446 GWh/vit 11.
Megjithatë, prodhimi i energjisë nga biomasa në bujqësi në nivel të fermave nuk po gjen interesim të lartë nga ana e fermerëve, pasi sektori po has në mangësi të mëdha (p.sh., madhësia e vogël e fermës, mungesa e objekteve dhe mekanizimit) të cilave duhet dhënë prioritet për t'iu siguruar fermave qëndrueshmëri ekonomike. Një ndikim i rëndësishëm në stimulimin e energjisë së ripërtëritshme u arrit përmes skemave të granteve të MBPZHR-së, siç janë paraqitur më poshtë:

8 Fletët e të Dhënave për Profilin e Rrezikut të Ndryshimeve Klimatike, Kosovë - https://www.climatelinks.org/sites/default/files/asset/document/2017_USAID_Climate%20Change%20Risk%20Profile%20-%20Kosovo.pdf
9 Raport i treguesve mjedisorë - http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedisi_i_Kosov%C3%ABs_2020_Raport_i_treguesit_mjedisor%C3%AB_-_SHQIP.pdf
10 Baza e të dhënave e Komisionit Evropian - https://agridata.ec.europa.eu/extensions/DashboardIndicators/DataExplorer.html?select=EU27_FLAG,1

Tabela 16 - Vlerësimi i kapaciteteve dhe përdorimit të energjisë së ripërtëritshme - panelave solarë në fermë/ndërmarrje bujqësore

Vitet	Nr. i fermave	Kapacitet[3] Kw	Bashkëfinancimi Vlera/€	Përkrahja publike/€	Përkrahja private/€
1	2	3	4 (3x1800 €)	5 (4 x 60%)	5 (4x 40%)
2014	135	540.00	972,000.00	583,200.00	388,800.00
2015	156	624.00	1,123,200.00	673,920.00	449,280.00
2016	193	675.50	1,215,900.00	729,540.00	486,360.00
2017	168	588.00	1,058,400.00	635,040.00	423,360.00
2018	222	666.00	1,198,800.00	719,280.00	479,520.00
2019	199	597.00	1,074,600.00	644,760.00	429,840.00
Totali	**1,073**	**3,690.50**	**6,642,900.00**	**3,985,740.00**	**2,657,160.00**

Burimi: MBPZHR

Pa asnjë subvencionim për kulturat energjetike (si në Shtetet Anëtare të BE-së) dhe me deficit të lartë tregtar në bujqësi, **Kosova nuk po prodhon bio-lëndë djegëse.**

Kosova ka potencial të mirëfilltë për të kontribuar në **zbutjen e ndryshimeve klimatike** përmes masave të **sekuestrimit të karbonit**, siç është **pyllëzimi i tokës bujqësore** (duke trajtuar edhe problemin e erozionit të tokës). Sa i përket **mirëmbajtjes së përdorimit ekstensiv të kullotave** (të njohura si 'absorbues karboni'), nuk ka asnjë pagesë kompensuese, pavarësisht përpjekjeve të PZHRB 2014-2020 për t'i promovuar skemat agro-mjedisore. Nga ana tjetër, praktikat, si **djegia e hamulloreve,** po zvogëlojnë lëndën organike të tokës/përmbajtjen e saj të karbonit.
Masa kryesore e **përshtatjes ndaj ndryshimit të klimës** mund të konsiderohet **rehabilitimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit**, por sistemi aktualisht kërkon investime dhe ristrukturim të rëndësishëm. **Racat lokale të kafshëve** dhe varietetet e bimëve përdoren ende nga fermat tradicionale në masë të madhe. **Kushtet lokale të përshtatura mirë** po ofrojnë elasticitet në rast të kushteve ekstreme klimatike, por nuk janë shumë produktive. Fermat e orientuara drejt tregut mund ta sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre përmes menaxhimit të rrezikut, por Kosova nuk posedon një treg të vërtetë për skemat e sigurimeve bujqësore, pasi aktualisht ato operojnë kryesisht në lidhje me agro-kreditë (në rast të humbjes së rendimentit, banka do të përfitojë nga primi i sigurimit). Për më tepër, **praktikat e mira për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike**, të tilla si përdorimi i kulturave mbulesë, moslërimi ose lërimi minimal, diversifikimi dhe rotacioni i kulturave bujqësore etj., **nuk promovohen nga sistemet këshilluese publike ose private.**

Pagesat direkte nuk janë të lidhura me asnjë kushtëzim mjedisor dhe ende asnjë masë agro-mjedisore nuk është ndërmarrë/zbatuar.

Përkundër të gjithave që u thanë më sipër, **është për t'u vlerësuar efikasiteti i vendit në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përmes kullotave të mëdha nën menaxhim ekstensiv dhe sistemi i mbjelljes me input të ulët (i cili mund të llogaritet si më efektiv sesa teknologjitë e avancuara dhe praktikat e mira të zbatuara në sistemet intensive të bujqësisë të vendeve të tjera).** Megjithatë, përgjatë zhvillimit të pritur të bujqësisë, praktikat e mira dhe investimet e lidhura me ndryshimet klimatike janë thelbësore, përndryshe, **ekziston rrezik i lartë të humbet një moment mundësie për ta siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe një përafrim të ngushtë me politikat e BE-së.**

[11] Analiza e Potencialit për Shfrytëzim të Energjisë së Ripërtëritshme në Sektorin e Energjisë në Kosovë, Lajqi, Shpëtim, Bojan Đurin, Xhevat Berisha dhe Lucija Plantak, 2020
[12]Kapacitetet mesatare të instaluara të energjisë së ripërtëritshme (panelave solare) për njësi të fermës/agrondërmarrjes, sillen nga: 3-4 kw.

Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB) në nëntor të vitit 2020, duke u përballur kështu me strategjinë e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane drejt *një ekonomie moderne, neutrale ndaj klimës, efikase në burime dhe konkurruese*. Ndër veprimet e rëna dakord janë *përafrimi me Ligjin e BE-së mbi Klimën* (sapo të miratohet), me një vizion të arritjes së neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, si dhe *përcaktimi i objektivave të energjisë dhe klimës për vitin 2030,* **përmes zhvillimit dhe zbatimit të masave të qarta të dizajnuara për t'i zvogëluar emetimet e gazrave serrë, duke integruar veprime klimatike në të gjitha politikat përkatëse sektoriale.**

5.2.2 Menaxhimi i burimeve natyrore si uji, toka dhe ajri

Sa i përket **cilësisë së ajrit**, amoniaku (NH_3) është ndotësi kryesor i ajrit. Aktivitetet bujqësore janë kontribuesit kryesorë në emetimet e amoniakut.[13]

Kosova nuk është pjesë e Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Gjatë (CLRTAP), dhe nuk nënshkroi Protokollin e Gothenburgut (për ta zvogëluar Acidifikimin, Eutrofikimin dhe Ozonin në nivelin tokësor), prandaj, nuk ka asnjë objektiv për zvogëlimin e emetimeve të amoniakut (në krahasim me Shtetet Anëtare të BE-së, të cilat detyrohen t'i zvogëlojnë emetimet e amoniakut, si rezultat i Direktivës së Angazhimeve Kombëtare për Reduktimin e Emetimeve (NEC)[14]).

Raportet e inventarit kombëtar të Kosovës mbulojnë emetimet kryesisht për sektorin e energjisë, ndërsa mungojnë të dhënat për disa sektorë të tjerë, përfshirë bujqësinë.

Nuk u identifikuan praktikat e mira mjedisore ose teknikat më të mira në dispozicion të promovuara ose vendosura nga legjislacioni kombëtar për zvogëlimin e emetimeve të amoniakut nga burimet bujqësore (të tilla si menaxhimi i plehut organik në shtalla, magazinimi dhe veçanërisht aplikimi i plehut natyral në tokë), as udhëzime specifike për fermerët në këtë drejtim (siç kërkohet nga Direktiva NEC).

Lidhur me tokat, është miratuar një metodologji për klasifikimin e tokave, por të dhënat në dispozicion janë shumë të dobëta, pasi vlerësimi i vetëm sistematik ishte kryer rreth 50 vjet më parë. Për sa i përket cilësisë, 56% e tokave konsiderohen të kenë cilësi të dobët, 29% cilësi mesatare dhe vetëm 15% - cilësi të mirë.[15] Mungojnë të dhënat mbi lëndën organike të tokës, ngjeshjen dhe kripëzimin e tokës.Sa i përket erozionit të tokës, të dhënat nuk janë mbledhur në mënyrë metodike, por bazuar në analizën GIS dhe modelimin e të dhënave të tjera, të tilla si përdorimi i tokës, klima dhe të dhënat topografike, janë nxjerrë informatat e mëposhtme:

[13] Menaxhimi i Ndotjes së Ajrit në Kosovë, Banka Botërore, 2019 - https://documents1.worldbank.org/curated/en/214511576520047805/pdf/Air-Pollution-Management-in-Kosovo.pdf

[14] https://www.eea.europa.eu/themes/air/air-pollution-sources-1/national-emission-ceilings

Tabela 17 - Erozioni i tokës sipas llojit dhe pjesëmarrjes

Nr.	Intensiteti i erozionit	Pjesa e sipërfaqeve totale të mbuluara me toka/dhera
1	Shumë i fuqishëm	7.35
2	I fuqishëm	16.1
3	I mesëm	35.4
4	I ulët	24.55
5	Shumë i ulët	10.1
6	Pa erozion	6.5

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik

Djegia e hamulloreve po e varfëron lëndën organike të tokës dhe nuk ka asnjë sistem për ta dekurajuar këtë praktikë.

Nuk ka skema mbështetëse për ta përmirësuar cilësinë e tokës. **Për sa i përket burimeve ujore**, me 4 lumenj të rëndësishëm (Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepeneci), Kosova ka rezerva të pamjaftueshme të cilat, në të ardhmen, mund ta kufizojnë zhvillimin ekonomik, duke u vlerësuar vetëm në 1,600 m^3 ujë/banor/vit.[16] Me rreth 20,000 ha sipërfaqe të ujitura dhe plane për 280,000 ha, bujqësia është përdoruesi i dytë i ujërave të ëmbla (pas konsumit publik), por me potencialin më të lartë për rritjen e kërkesës për ujë.

Sa i përket **cilësisë së ujit** , të dhënat mbi përqendrimet e **nitrateve** nga ujërat sipërfaqësore të publikuara në *Raportin e treguesve mjedisorë*, 2020, tregojnë përqendrime shumë të ulëta mesatare gjatë viteve 2009 - 2019, me një maksimum prej 1.162 mg NO_3/l në vitin 2013 dhe një nivel prej 1.1 mg NO_3/l në vitin 2019 (ndërsa niveli maksimal i përqendrimit me Direktivën për Nitratet është 50 mg NO_3/l). Burimet kryesore të nitrateve janë plehu organik (nga sektori i blegtorisë), plehrat kimike dhe uji i patrajtuar i ujërave të zeza.

Nuk ka detyrime apo rekomandime për fermerët për përdorimin e duhur të plehut organik dhe plehrave kimike (në vendet e BE-së, këto informata përfshihen në një Kod për Praktikat e Mira Bujqësore dhe një Program Veprimi për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes me nitrate të shkaktuar nga bujqësia, dokumente që janë përgatitur bazuar në dispozitat e përfshira në Direktivën për Nitratet[17] - një nga direktivat më të rëndësishme mjedisore).

Sipas *Raportit të treguesve mjedisorë*, 2020, **përdorimi i plehrave kimike u rrit nga rreth 71,000 tonë në vitin 2015, në rreth 76,000 tonë në vitin 2019** (llogaritur në rreth 78,500 tonë në Raportin e Gjelbër, 2020). Megjithatë, informatat e dhëna janë vetëm për sasitë e përgjithshme të plehrave kimike dhe jo për sasitë e përmbajtjes së azotit të pastër, duke e bërë kështu të vështirë vlerësimin e përdorimit real të azotit, i cili duhet të vlerësohet për ha të sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore. Sasia mesatare e plehut organik të aplikuar, siç është vlerësuar nga Anketa e Ekonomive Bujqësore nga viti 2019 18 është 14.6 tonë/ha, ndërsa për perimet, vlera mesatare është 20 tonë/ha. Duke marrë parasysh që përqendrimi i N në plehun organik të kompostuar është rreth 1%, rezulton se shpërndarja mesatare e azotit nga plehrat organike është 146 kg N/ha, ndërsa për perimet është 200 kg N/ha, që në fakt është më shumë se sa lejohet nga Direktiva për Nitratet (kufiri është 170 kg N/ha/vit). Numri i vogël i kafshëve për fermë dhe mungesa e pajisjeve për kompostimin, ngarkimin, transportimin dhe aplikimin në fushë, e bën të vështirë marrjen parasysh të vlefshmërisë së vlerave të mësipërme.

[15] http://seerural.org/wp-content/uploads/2016/07/Kosovo-report.pdf

16 Gjendja e Ujërave në Kosovë, 2010- https://www.ammk-rks.net/repository/docs/raporti_ujrave%202010_shq.pdf

[17] https://ec.europa.eu/environment/water/water-nitrates/index_en.html

Menaxhimi i plehut organik është kryesisht i papërshtatshëm në nivel të fermave. Problemet fillojnë me shtallat të cilave u mungojnë sistemet për grumbullimin e jashtëqitjeve, enët e ruajtjes dhe pajisjet për trajtimin e plehut organik brenda depove dhe aplikimit në fushë, duke rritur kështu rrezikun e humbjeve të azotit në ajër (si emetimet e amoniakut) dhe në ujë (si amoniaku dhe veçanërisht nitratet). Ekziston një kërkesë e lartë për ujë për industrinë agro-përpunuese, si dhe **një rrezik i lartë i ndotjes së ujit, të shkaktuar veçanërisht nga qumështoret.**

Me mbështetjen publike për **bujqësinë organike** të zbatuar që nga viti 2016, sipas të dhënave të MBPZHR, janë **480 ha** me bimë mjekësore dhe aromatike të certifikuara në sistemin e bujqësisë organike, me 35 prodhues. Për më tepër, ka 522.47 ha me kungulleshka të kultivuara për prodhimin e vajit organik dhe 34.07 ha me arra organike. Pavarësisht kërkesës së lartë të tregut dhe krahasuar me zonat nën bujqësinë organike nga vendet e BE-së, vlerat janë jashtëzakonisht të ulëta. Vlen të kujtohet se Strategjia e BE-së " nga ferma në tryezë" (*Farm-to-Fork)* po synon 25% të sipërfaqeve të përgjithshme bujqësore nën bujqësinë organike deri në vitin 2030, që për Kosovën do të thotë rreth 105,000 ha. Një nga pengesat kryesore është mungesa e një sistemi kombëtar për certifikimin dhe inspektimet e bujqësisë organike.

Për sa i përket sipërfaqeve **organike të certifikuara për grumbullimin e pemëve të egra dhe bimëve mjekësore, janë 373,488 ha të certifikuara të lidhura me 45 qendra grumbullimi**, por nuk ka asnjë sistem rigoroz kontrolli që mund ta vërtetojë respektimin e duhur të rregullave (veçanërisht ato që lidhen me pjesën e pemëve të egra dhe bimëve aromatike që duhet të mbeten të pavjelura). Përveç një projekti të buxhetit shtetëror për trajnimin e fermerëve në zbatimin e testeve të tokës dhe për interpretimin e rezultateve të testeve, sistemi këshillues kishte veprime shumë të kufizuara në promovimin e praktikave të mira mjedisore për ruajtjen e burimeve natyrore.

5.2.3 Biodiversiteti, shërbimet e ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe natyres

Kosova ka një biodiversitet të pasur dhe peizazhe të bukura malore, si vend i ri, Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë konvente e as palë në ndonjë marrëveshje në fushën e mbrojtjes së natyrës, pra ajo nuk ka asnjë detyrim ndërkombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit. Megjithatë, në vitin 2019 Kosova është anëtarësuar në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës – IUCN, në të cilin qeveritë, OJQ-të, shkencëtarët, bizneset, komunitetet lokale dhe të tjerët formojnë dhe zbatojnë zgjidhjet së bashku për sfidat mjedisore.

Sipas Raportit të Gjendjes së Natyrës 2008 - 2009 AMMK, 2010, vendi ka 97 zona të mbrojtura, me një sipërfaqe totale prej 47,842.34 ha (ose 4.39 % të territorit të Kosovës), të deklaruara në përputhje me kategoritë e Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). **Asnjë nga zonat e mbrojtura nuk ka plane menaxhimi.**
Mbulueshmëria e zonave të mbrojtura është mjaft e vogël në krahasim me rrjetin Natura 2000 të BE-së, i cili shtrihet mbi 18% të sipërfaqes tokësore të BE-së dhe në më shumë se 8% të territorit të saj detar. Sidoqoftë, **Kosova u zotua përmes Deklaratës së Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në rritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin e detyrimeve mjedisore për monitorimin, promovimin dhe zbatimin e pajtueshmërisë me prioritetet e BE-së mbi biodiversitetin**. Për më tepër, **Strategjia e BE -së për Biodiversitetin për vitin 2030** përfshin angazhime dhe veprime shtesë që do të realizohen deri në vitin 2030, duke përfshirë krijimin e një rrjeti më të madh të zonave të mbrojtura.

Si rezultat i një studimi,[19] Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Koritniku, Pashtriku, Kozniku, Gërmia, Bjeshkët e Kopaonikut dhe Mirusha janë klasifikuar si qendra të biodiversitetit të florës, faunës dhe ekosistemeve në Kosovë, duke u klasifikuar kështu si **zona të mundshme për Rrjetin Natura 2000**. Në këto zona, u identifikuan 41 lloje zogjsh të cilët përfshihen në Shtojcën I të Direktivës për Zogjtë (pjesë e Natura 2000).

[18] Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2019 -https://ask.rks-gov.net/media/5488/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2019-2.pdf

Vendi ka përgatitur një Strategji dhe Plan Veprimi për Biodiversitetin 2011 - 2020, me kapituj të veçantë për bujqësinë dhe pylltarinë. Ndër prioritetet që përmenden janë ruajtja e zonave me karakteristika të veçanta përfaqësuese të habitateve natyrore duke aplikuar bujqësinë tradicionale, edukimi i fermerëve lidhur me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve dhe menaxhimi me pyjet në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe pyllëzimin me speciet vendore.

Për sa i përket pyjeve, mbulueshmëria e vendit është rreth 44.7% (481,000 ha). Pronësia e sektorit privat vlerësohet në 40%. Në 10 vitet e fundit, sipërfaqet pyjore u rritën me rreth 20,200 ha nga pyllëzimi natyror (i kullotave, kryesisht për shkak të nënkullotjes) dhe rreth 4,000 ha përmes pemëve të mbjella. Pyjet cungishte dominojnë në zonën pyjore me 84 %. Pyjet e pastra gjethegjera mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore; specia mbizotëruese është ahu, pyjet halore mbulojnë 7% të tokës pyjore dhe aty dominon bredhi dhe pisha.[20] **Pyjet konsiderohen se kanë një biodiversitet të lartë.**

Për shkak të specifikave të sektorit, MBPZHR- ja po përgatit një strategji të dedikuar për pylltarinë për periudhën 2021-2030 dhe analiza brenda këtij dokumenti nuk ka për qëllim përsëritjen e saj, por vetëm sinkronizimin me të. Nevojat prioritare dhe ndërhyrjet e parashikuara për sektorin do të mbeten të ruajtura brenda strategjisë për pylltarinë.

Ndërsa bujqësia po **zhvillohet, intensifikimi dhe braktisja e tokës janë kërcënime serioze për biodiversitetin**. **Biodiversiteti i kullotave preket kryesisht nga nënkullotja** në zonat e largëta dhe kështu priret për pyllëzime natyrore ose të dominohen nga specie invazive, duke ulur vlerën e biodiversitetit të tyre. Të rinjtë nuk e shohin si tërheqëse punën e barinjve tradicional. Në të njëjtën kohë, ekziston gjithashtu rreziku për të qenë nën një përdorim më intensiv (nivele të larta të kimikateve dhe mbjelljeve të tepërta) dhe madje mund të shndërrohet në tokë të punueshme, veçanërisht në zonat më të ulëta dhe afër vendbanimeve njerëzore. Sidoqoftë, shumica e kullotave kryesisht fertilizohen në mënyrë natyrale; kullotat janë ende nën kullotje ekstensive dhe livadhet kanë datat e kositjes tradicionalisht të vonuara, por koncepti i tokës bujqësore me vlerë të lartë natyrore[21] ende nuk është përcaktuar dhe i njohur.

Toka e punueshme është kryesisht nën një sistem me input të ulët për shkak të bujqësisë në shkallë të vogël, por nën kërcënimin e intensifikimit të bujqësisë. Zonat që përdorën pesticide u zgjeruan nga115,000 ha sa ishin në vitin 2015, në 119,000 në vitin 2019 - siç u përmend nga Raporti i treguesve mjedisorë, 2020. Procesi i nevojshëm i konsolidimit të tokës është një rrezik për pemët e vetmuara **dhe grupet e pemëve**, me sistemin aktual të kontrollit për mbrojtjen e mjedisit të rregulluar dobët.

Politika për bujqësinë nuk parashikon asnjë kushtëzim mjedisor për pagesat e drejtpërdrejta ose masën stimuluese/shpërblimin e fermave për të ardhura të humbura dhe me shtesa. Rritja e pritshme e pesticideve në ultësira dhe zvogëlimi i dendësisë së kullotjes në zonat malore do të ndikojë më tej në biodiversitetin në rast të mungesës së masave të politikave. Zonat malore janë përcaktuar dhe përvijuar. Pavarësisht prirjes për braktisje të tokës, nuk ka pagesa kompensuese për të ardhurat e reduktuara të fermës për shkak të lartësisë dhe shpateve dhe skemat e tanishme të granteve nuk janë duke synuar veçanërisht zonën (nuk ka poena shtesë përmes sistemit të përzgjedhjes dhe shkallë më të lartë të intensitetit të mbështetjes publike). Zonat malore janë përcaktuar dhe përvijuar. Pavarësisht prirjes për braktisje të tokës, nuk ka pagesa kompensuese për të ardhurat e reduktuara të fermës për shkak të lartësisë dhe shpateve dhe skemat e tanishme të granteve nuk janë duke synuar veçanërisht zonën (nuk ka poena shtesë përmes sistemit të përzgjedhjes dhe shkallë më të lartë të intensitetit të mbështetjes publike).

[19] https://www.researchgate.net/figure/Potential-Zones-for-Ecological-Network-Nature-2000-in-Kosovo-3_fig1_220740571

20 Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016 - 2020, 2016 - https://web.archive.org/web/20181003181801/https://mmph.rks-gov.net/repository/docs/Eng__SAPB_2016-2020_188255.pdf

[21] https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/data/high-nature-value-farmland

Menaxhimi i dobët i mbeturinave është një problem i dukshëm. Mbeturinat përgjatë rrugëve dhe lumenjve dhe hedhjet e paligjshme ndikojnë në ajrin, tokën, ujin dhe biodiversitetin.
Në lidhje me objektivat e Strategjisë "**nga ferma në tryezë**" (Farm-to-Fork), ndërsa rritja e sipërfaqeve me bujqësi organike i jep rast rritjes së kërkesës së tregut më tepër, se sa kërkesa për reduktimin e **përdorimit intensiv të plehrave dhe pesticideve, ruajtja e tyre e duhur dhe teknikat e aplikimit në fushë janë problemet kryesore në Kosovë**.
Fermerëve u mungon trajnimi specifik për përdorimin e duhur të pesticideve dhe për agro-mjedisin. Mungojnë tregues të rëndësishëm bazë: sasitë aktuale të përdorura, produkte kimike (kg pesticide/ha, kg azot/ha), indeksi i shpendëve të tokës bujqësore, zona bujqësore me vlerë të lartë natyrore, bilanci bruto ushqyes dhe nitratet në nëntokë.

Matrica SWOT Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore dhe ndikimi ne ndryshimet klimatike

PËRPARËSITË	**MANGËSITË**
Pylltaria	***Pylltaria***
- Rreth 45% e territorit të Kosovës është e mbuluar me pyje; te cilat kanë potencial të shfrytëzimit shumëqëllimor; - Ekzistimi i pyjeve me prejardhje natyrore me diversitet të pasur; - Ekzistimi i strukturave menaxhuese të themeluara sipas bazës ligjore; - Ekzistimi i kapaciteteve (hapësira te zhveshura) për pyllëzim dhe ripyllëzim (Plani Kombëtar për pyllëzim dhe ripyllëzim 2018-2027); - Pyje të pasura me PPJD;	- Niveli i larte i prerjeve të parregullta të pyjeve; - Mungesa e investimeve shtetërore në pylltari - Mospërfshirja në planifikimin e përdorimit shumëqëllimor të pyjeve; - Infrastruktura pyjore të dobëta; - Mungesa e investimeve të huaja; - Mungesa e masave silvikulturore, në kultivimin dhe kujdesin e pyjeve, si dhe në shëndetin pyjor; - Struktura menaxhuese jo të koordinuara dhe me efikasitet të pamjaftueshëm; - Shfrytëzimi ne shpërputhje i potencialit prodhues te pyjeve; - Mosmbështetja e sektorit te pylltarisë me pagesa direkte dhe grante; - Mungesa e një sistemi për menaxhimin e informatave në pylltari, përkatësisht të Sistemit Informatik të Pylltarisë në Kosovë, si dhe e teknologjive të tjera të informacionit; - Mungesa e shërbimeve këshillimore për pronarët e pyjeve private në pylltari;
Çështje të tjera mjedisore dhe klimatike	***Çështje të tjera mjedisore dhe klimatike***
- Niveli i ulët i emetimeve (për shkak të zvogëlimit të blegtorisë); - Traditë e gjatë në menaxhimin ekstenziv të kullotave;	- Më shumë se gjysma e tokave janë të ekspozuara ndaj erozionit të tokës (me të paktën një intensitet mesatar); - Ekziston një metodologji për klasifikimin e tokave dhe përdorimin e të dhënave të ndryshme, të tilla si nga inventari i Corine Land Cover, por nuk ka harta

- Racat lokale të përshtatura mirë; - Nivele të ulëta të nitrateve në ujërat sipërfaqësore; - Janë identifikuar zonat potenciale për Rrjetin Natura 2000; - Biodiversitet shumë i pasur dhe peizazhe të bukura malore; - Përqindje e lartë e bujqësisë tradicionale me input të ulët, veçanërisht për shkak të bujqësisë në shkallë të vogël; - Përpjekje të kufizuara për konvertimin në bujqësi organike; - Përvijimi i zonave malore.	të besueshme të të dhënave/përfshirë GIS, pasi testet e tokave janë të vjetra dhe të pamjaftueshme; - Nuk ka konventa dhe protokolle ndërkombëtare të zbatueshme për Kosovën; - Sipërfaqe të vogla të mbuluara nga zona të mbrojtura ku mungojnë planet e menaxhimit; - Braktisja e tokës në zonat malore po e ul biodiversitetin e kullotave; - Menaxhimi i dobët i plehut organik dhe kimikateve; - Djegia e hamulloreve po e zvogëlon lëndën organike në tokë; - Toka bujqësore me vlerë të lartë natyrore e paidentifikuar (edhe pse qartësisht ekzistuese); - Ndotja e ujit e shkaktuar nga industria agroushqimore; - Implementimi dhe zbatimi i dobët i politikës mjedisore; - Mungesa e treguesve të ndryshëm bazë; - Niveli i ulët i ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit dhe masat për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike; - Menaxhimi i dobët i mbeturinave.
- - MUNDËSITË - Pylltaria - Kushtet e volitshme klimatike dhe tokësore për rritjen e drunjve dhe të PPJD-ve; - Vlerat ekonomike, sociale dhe mjedisore të njohura mirë me rastin e menaxhimit shumëfunksional të pyjeve; - Diversifikimi i ekonomisë rurale, zhvillimi i ekoturizmit dhe krijimi i vendeve të reja të punës; - Çështje të tjera mjedisore dhe klimatike - Nënshkrimi i konventave dhe protokolleve ndërkombëtare do të çojë në një natyrë më të mbrojtur; - Kërkesa e lartë për eksport për produkte organike; - Përfitimi nga kostot oportune[4] për kompensimin e praktikave ekstenzive bujqësore siç përcaktohet nga udhëzimet e BE-së.	- - KËRCËNIMET - Pylltaria - Prerjet ilegale të pyjeve**;** - Dëmet nga zjarret, faktorët biotikë dhe abiotikë në shëndetin pyjor**;** - Sistem i jo efektiv i monitorimit**;** - Futja e llojeve invazive dhe humbja e bazës gjenetike**;** - Ndotja e ekosistemeve pyjore nga mbeturinat e ndryshme**;** - Ndryshimet klimatike**;** - Rrezikimi i habitatit**;** - Çështje të tjera mjedisore dhe klimatike - Ndryshimi i klimës mund të ndikojë në biodiversitetin dhe të rrisë erozionin e tokës**;** - Intensifikimi i bujqësisë në ultësira pa miratimin e praktikave të mira mund të çojë në humbje të biodiversitetit dhe ndotje të ujit për shkak të përdorimit të papërshtatshëm të pesticideve dhe plehrave**;** - Masat e ruajtjes për zonat e mbrojtura mund të vendosin kufizime bujqësore pa përcaktuar skemat e duhura të pagesave kompensuese.

[4] Kostot oportune u referohen pagesave kompensuese për bujqësinë ekstenzive për të shmangur braktisjen e tokës ose intensifikimin e bujqësisë

5.3 Zonat rurale dhe infrastruktura socio-ekonomike

5.3.1 Punësimi, përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal në zonat rurale

Me një dendësi shumë të madhe të popullsisë (rreth 170 banorë/km^2), **rreth 57% e popullsisë së vendit (1.873 milion) jeton në zona rurale**, krahasuar me mesataren e BE-së prej 15%. Zonat rurale varen kryesisht nga sektori parësor dhe kanë të ardhura për kokë banori që janë dukshëm më të ulëta se mesatarja e vendit (me një të tretën në rastin e vendeve të BE-së). Pavarësisht **nga rritja relative e fuqishme blerëse** në nivel kombëtar gjatë viteve 2015 - 2019, Kosova mbetet me vlerën më të ulët në ekuivalencë me fuqisë blerëse në rajon.

Tabela 18 – BPV-ja për kokë banori ekuivalent me fuqisë blerëse

Vendet	2015	2016	2017	2018	2019	Variacioni
	BPV-ja për kokë banori ekuivalent me fuqisë blerëse /$					
Bullgaria	18,343	20,019	21,387	22,911	24,579	34.00%
Kroacia	23,005	24,876	26,800	28,554	30,245	31.48%
Maqedonia e Veriut	13,827	15,077	15,649	16,671	17,583	27.16%
Mali i Zi	16,332	18,199	19,682	21,547	23,343	42.93%
Serbia	14,928	15,858	16,611	17,736	18,929	26.80%
Kosova	9,575	10,062	10,530	11,156	11,930	24.60%

Burimi: Të dhënat e Bankës Botërore - https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.PP.CD?end=2019&locations=XK&start=2019&view=map

Indeksi i cilësisë së jetës për zonat rurale nuk është i disponueshëm, por me 42% të konsumit vjetor të ekonomive familjare vetëm në ushqim, 26% në banim dhe vetëm 0.25% në arsim dhe 0.45% në rekreacion[23], **cilësia e jetës mund të konsiderohet shumë e ulët**.

Kosova është e shënuar si një "vend i sigurt i origjinës", por **mungesa e vendeve të punës dhe infrastrukturës bazë e nxit migrimin**. Për migrim ndërkombëtar po preferohet Zvicra, Gjermania dhe Italia. Të kthyerit janë një grup veçanërisht i cenueshëm, zakonisht me pozitë më të keqe ekonomike në krahasim me situatën e tyre para migrimit dhe me probleme të strehimit. Megjithatë, problemi më i rëndësishëm mbetet mungesa e vendeve të punës. Papunësia është më tepër një rregull sesa përjashtim dhe zakonisht shumë anëtarë të ekonomisë familjare varen vetëm nga një person që fiton të ardhura ose varen plotësisht nga shuma e vogël e mirëqenies sociale që ata marrin (Judith Möllers et al, 2017).


Të ardhurat e popullsisë **vazhdojnë të plotësohen me remitenca**, mesatarisht rreth 80 milionë euro në muaj. Rreth 28% e ekonomive familjare kategorizohen si ekonomi familjare migrante, që do të thotë se ata kanë të paktën një anëtar të familjes që jeton jashtë vendit. Mesatarisht, numri i migrantëve është 2.5. Rreth 60% e këtyre ekonomive familjare migrante marrin remitanca, që kontribuojnë mesatarisht në 13% të të ardhurave të tyre.[24]

Trendi i remitancave në Kosovë gjatë periudhës 2017 – 2021



Burimi: TrendingEconomics.com (bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës) - https://tradingeconomics.com/kosovo/remittances

Kosova mbështetet kryesisht në kapitalin vendor për investime të reja. Duke marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik dhe vëllimin e remitencave që janë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e potencialit financiar për zhvillimin e biznesit, mund të vlerësohet se **rritja e paritetit të fuqisë blerëse dhe remitencave nuk është shumë e lartë që vetëm ato të prodhojnë ndryshime të rëndësishme në ekonominë lokale në vitet e ardhshme. Papunësia**, edhe pse ka rënë ndjeshëm gjatë viteve 2009 - 2019, është ende një problem i rëndësishëm në Kosovë, **me një nga vlerat më të larta në rajon, veçanërisht për gratë**.



[23] Kosova në shifra, 2019

[24] Studim mbi Migracionin Rural dhe Migracionin e Kthimit në Kosovë, Judith Möllers, Diana Traikova, Thomas Herzfeld, dhe Egzon Bajrami, 2017

Infrastruktura bazë në zonat rurale mbetet e dobët. Ekziston një nevojë e madhe për rrugë rurale, sisteme uji dhe kanalizimesh (përfshirë impiantet e trajtimit të ujit). **Rrjeti rrugor është zgjeruar vitet e fundit, por është ende i pamjaftueshëm**, duke marrë parasysh fragmentimin e tokës të vendit. Në vitin 2019, nga 2,311.7 km të rrugëve, pothuajse 4.4% nuk kanë asfalt si shtresë të sipërme.

Tabela 19 - Gjatësia e rrugëve (km)

Lloji i rrugës	2015	2016	2017	2018	2019	Variacioni 2015 -2019
Autostradë	78.0	98.0	108.0	119.1	137.2	**75.90%**
Kombëtare	630.4	630.4	630.4	641.7	665.2	**5.52%**
Rajonale	1,305.0	1,305.0	1,305.0	1,313.9	1,509.4	**15.66%**
Gjithsej	**2,013.4**	**2,033.4**	**2,043.4**	**2,074.7**	**2,311.7**	**14.82%**

Burimi: Ministria e Infrastrukturës

Rrugët e pamjaftueshme pyjore po e bëjnë të vështirë zbatimin e një sistemi të qëndrueshëm të shfrytëzimin e drurit, **ndërsa infrastruktura e dobët rrugore për qasje në parcelat bujqësore** po detyron pajisjet bujqësore të çrregullojnë trafikun në rrugët kombëtare dhe rajonale.

Sipas *Statistikave të Ujërave në Kosovë 2018-2019*, në vitin 2018, vetëm rreth 86.31 % e popullsisë së vendit ishte e lidhur me një **infrastrukturë të sistemit të ujit**, me një dallim të fortë ndërmjet zonave urbane dhe rurale: ndërsa në zonat urbane përqindja është 99%, **në zonat rurale arrin në vetëm 61%**. Niveli i lidhjes me sistemin e ujërave të zeza është edhe më i ulët, pasi janë të lidhur vetëm 65% e popullsisë nga zona ku operon Kompania Rajonale e Ujit. Me përjashtim të një qyteti (Skenderaj), **ujërat e zeza derdhen drejtpërdrejt në lumenj**, pa u trajtuar, duke kontribuar në ndotjen e ujit. Ndërsa furnizimi i vendit me **energji elektrike** është përmirësuar kohët e fundit, **ka ende probleme të rëndësishme me rrjetet lokale të cilat kanë nevojë për rehabilitim dhe modernizim**, veçanërisht në zonat rurale.

Në vitin 2019, **93.2% e familjeve në Kosovë kanë pasur qasje në internet në shtëpi ose banesa nga një pajisje**, por niveli i përdorimit të internetit mbetet i ulët në mesin e të moshuarve dhe të rinjve (Anketa e Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit, 2019). Në Kosovë, **ekzistojnë 1,564 vende të trashëgimisë kulturore me mbrojtje të përkohshme**, të cilat, së bashku me amenitetet natyrore, janë një bazë shumë e shëndoshë për zhvillimin e turizmit rural.

Sa i përket zhvillimit të biznesit rural dhe diversifikimit ekonomik, ndërhyrja më e rëndësishme publike ishte skema e granteve të MBPZHR për diversifikim. Siç u përmend nga *Studimi Sektorial për Diversifikimin*, 2021, në periudhën 2014-2020, u miratuan gjithsej 563 projekte, me një vlerë totale investimi prej 14 milionë euro, nga të cilat 8 milionë euro pagesa përfundimtare, me një vlerë mesatare të projektit prej 29,127 euro dhe një vlerë mesatare e grantit prej 18,242 euro. Mbështetja publike mbuloi akuakulturën, produktet pyjore jodrusore (NWFP), bimët mjekësore dhe aromatike (MAP), turizmin rural, bletarinë, zanatet dhe përpunimin në fermë. Buxheti më i madh ishte për bletarinë (3.48 milionë euro). Përveç këtyre ndërhyrjeve të MBPZHR -së, Zyra e BE-së në Kosovë ndau 8,7 milionë euro. Mbështetje shtesë për projektet u sigurua nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Malin e Zi. USAID, GIZ, SWISS Contact, SIDA etj. janë gjithashtu donatorë të rëndësishëm, kontributi i të cilëve u vlerësua shumë për zhvillimin e sektorit.

Grumbullimi iPPJD dhe MBA është një nga bizneset më të rëndësishme rurale. Aktiviteti mbështetet në vjeljen e florës së egër nga tetë zona, ku dy nga zonat e grumbullimit i përkasin parqeve kombëtare. Më shumë se 300 lloje të produkteve pyjore jodrusore (NWFP) dhe bimëve aromatike dhe mjekësore (MAP) janë mbledhur dhe janë kultivuar një numër i konsiderueshëm i llojeve. Disa lloje (p.sh. boronica, dëllinja, shtogu, mollët e egra, gështenjat etj.) kanë një vlerë shumë të lartë tregtare dhe po kontribuojnë fuqishëm në gjenerimin e të ardhurave dhe mirëqenien ekonomike të familjeve që jetojnë në zonat rurale. **Vendi vlerësohet të ketë rreth 20,000 mbledhës**,

kryesisht gra dhe fëmijë dhe shpesh familje të tëra, fitimi i të cilëve ndryshon ndërmjet 12-15 euro në ditë (Studimi Sektorial mbi Diversifikimin, 2021),cili mund të konsiderohet një kosto shumë e ulët për sektorin. Produktet kanë një kërkesë të fortë në treg dhe kanale të konsoliduara të shpërndarjes. Disa shqetësime janë ngritur mbi qëndrueshmërinë e këtij lloji të biznesit, **pasi aktiviteti është nën një kontroll të dobët shtetëror**. **Ekziston rreziku i shterimit të burimeve natyrore për shkak të vjeljes së tepërt.**
Pavarësisht skemave të granteve, **ka ende një rrugë të gjatë përpara për të siguruar pajtueshmërinë me standardet që lidhen me sigurinë e ushqimit dhe mjedisin.** Zbatimi i dobët i ligjit, kapaciteti i kufizuar institucional për të monitoruar dhe kufizimet financiare të sektorit privat janë pengesat kryesore, që çojnë në **rreziqe sigurie për kompanitë dhe konsumatorët. Përmes Agjendës së Gjelbër të Ballkanit**

Përndimor, Kosova ka miratuar Objektivat e Strategjisë së BE-së "Nga ferma në tryezë" që deri në vitin 2030 të zvogëlojë përdorimin e përgjithshëm dhe rrezikun nga pesticideve kimike në 50%, dhe të bëjë reduktimin e shitjeve të antimikrobikëve për kafshët në fermë në 50%; megjithatë, kjo është shumë sfiduese për Kosovën dhe do të kërkojë një zbatim të kujdesshëm. Kështu, duket se për Kosovën rritja e efikasitetit në përdorimin e pesticideve është më e rëndësishme sesa zvogëlimi i përdorimit, pasi aktualisht përdorimi është i ulët, por njohuritë specifike për aplikimin e pesticideve dhe pajisjet moderne janë të mangëta, që kërkojnë ndërgjegjësim dhe trajnim intensiv, programe, grante për pajisje dhe makineri. Për më tepër, institucionet kanë nevojë për konsolidim në zbatimin e Direktivës së BE-së për përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve, veçanërisht për ngritjen e një rrjeti pajisjesh për matje, mbikëqyrje dhe alarmim të sëmundjeve bimore, laboratorë të lëvizshëm për inspektimin dhe kalibrimin e pajiseve të terrenit për pesticide, pajisje për përforcimin e kapaciteteve të laboratorëve për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe për digjitalizimin që e siguron përcjelljen e pesticideve, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave në lidhje me përdorimin e pesticideve dhe forcimin e kapacitetit raportues. Për sa i përket përdorimit të antimikrobikëve, përdorimi mund të reduktohet duke promovuar standardet e mirëqenies së kafshëve, sepse siç dihet, sa më të mira të jenë standardet, aq më e ulët është nevoja për antimikrobikë**.**
Sa i përket bletarisë dhe prodhimit të mjaltit, Kosova ka një mjedis të përshtatshëm, që inkurajohet edhe nga përdorimi i ulët i pesticideve. Me një kërkesë shumë të lartë të mjaltit në tregun vendor, çmimet janë më të larta se në vendet e BE-së. Zhvillimi i sektorit u mbështet gjithashtu nga rritja e buxhetit të pagesave direkte nga 500,000 euro në vitin 2019, në 3 milionë euro në vitin 2019. **Pothuajse i gjithë prodhimi vendor (i vlerësuar nga MBPZHR në 2,198 tonë për vitin 2020) ndjek kanalet joformale të tregut**. Megjithatë, sektori ka të metat e tij: shëndeti i dobët i kolonive si rezultat i cilësisë së ulët të produkteve të përdorura në bletari dhe praktikat e dobëta të aplikuara në bletari.
Në lidhje me akuakulturën, kultivimi i peshkut tregon një prirje pozitive të rritjes, veçanërisht për shkak të prodhimit të troftës ylber (Oncorhynchus mykiss), prodhimi aktual i të cilit vlerësohet në rreth 1581 tonë (Studimi Sektorial mbi Diversifikimin, 2021). Megjithatë, **mungon një politikë tregu në përputhje me *acquis* të BE-së, si dhe një inventar i llojeve të peshkut** dhe kapacitete më të forta administrative për menaxhimin, inspektimin dhe kontrollin e politikave (Raporti Vjetor i Progresit, Komisioni Evropian, 2020). Peshkimi mbetet i lidhur ngushtë me zhvillimin e turizmit lokal, ndërkohë që burimet ujore kanë nevojë për një vëmendje të veçantë në rast se ky sektor rritet në shkallë.
Në lidhje me turizmin rural, sektori po dëshmon rolin e tij në krijimin e të ardhurave shtesë në zonat rurale. Me një rol të fortë në integrimin e ekonomisë lokale dhe shtimin e vlerës të produkteve bujqësore vendore, turizmi rural është prekur fuqishëm nga COVID-19 dhe kërkon një vëmendje të veçantë në periudhën e ardhshme. Megjithatë, turizmi rural kryesisht nuk është i lidhur me bujqësinë; zhvillimi i agro-turizmit u dëshmua i vështirë. Mungon trajnimi specifik për fermerët me potencial për të ofruar shërbime bazë turistike (fjetja dhe mëngjesi).
Ekonomia rurale në Kosovë mund të konsiderohet e gjelbër, përderisa fuqia blerëse është e dobët dhe bujqësia tradicionale po vazhdon të përdorë me mençuri burimet vendore. **Kërcënimet reale lidhen me përdorimin e pakontrolluar të pesticideve, vjeljen e tepërt të PPJD dhe BMA të egra dhe ndotjen plastike. Praktikat e mira mjedisore kryesisht mungojnë dhe promovohen dobët.**

5.3.2 Zhvillimi lokal

Kosova ka krijuar 12 Grupe Lokale të Veprimit (GLV), të cilat janë të organizuara në një rrjet. **Një përvojë e mirë është fituar në nivelin e ministrisë në menaxhimin e LEADER** (nga frëngjishtja "Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale") dhe Veprimet e Zhvillimit Lokal të Drejtuar nga Komuniteti (CLLD).[25] **GLV-të kanë njohuri në përgatitjen e strategjive të zhvillimit lokal (SZHL) dhe në identifikimin e projekteve me rëndësi lokale.** Interesi për GLV-të është i lartë - përfaqësues të tjerë lokalë shprehin interesin e tyre për këtë qasje.

Megjithatë, në të kaluarën e afërt, **GLV-të u privuan nga burimet thelbësore financiare për funksionimin e tyre, duke rrezikuar edhe ekzistencën e tyre dhe duke ngritur çështje besimi në qasjen.** Për më tepër, sistemi i zbatimit të Agjencisë së Pagesave nuk është përshtatur me specifikat e GLV-ve, pasi sistemi i pagesave është krijuar për rimbursimin e kostove për skemat e granteve dhe nuk po e adreson nevojën e vazhdueshme të parave të gatshme për kostot rrjedhëse të GLV-ve.

Karakteristikat e ndryshme **vitale operative për GLV-të nuk janë të përcaktuara qartë dhe janë identifikuar boshllëqe të rëndësishme në detyrat administrative dhe funksionale të GLV-ve** (për shembull, mungon një listë e detajuar e kostove rrjedhëse, një ndarje e qartë ndërmjet një organi të brendshëm vendimmarrës dhe një organi përzgjedhës, perspektiva e GLV-ve si menaxherë të strategjisë së zhvillimit lokal, sesa si përfitues përfundimtarë të granteve, etj.) Komunat po vazhdojnë të lansojnë skema mbështetëse lokale për fermerët, të cilat nuk janë pjesë e politikës së ministrisë së linjës, as të strategjive të zhvillimit lokal, duke humbur kështu mundësinë për të siguruar koherencë në iniciativat lokale, si dhe për të tërhequr buxhetin vendor për zbatimin e LDS.

GLV-të ekzistuese nuk janë ende gati për marrjen e përgjegjësive më të larta në përzgjedhjen e projekteve lokale sipas prioriteteve lokale **pa trajnime të mëtejshme**, të marra nga persona me përvojë/GLV-të e tjera nga vendet e BE-së.

5.3.3 Ushqim i shëndetshëm dhe siguria ushqimore

Përveç përpjekjeve të Agjencisë së Veterinarisë në sigurimin e sigurisë së ushqimit dhe standardeve të shëndetit të kafshëve, **pak vëmendje i kushtohet cilësive ushqyese të ushqimit, qëndrueshmërisë së sistemeve të prodhimit dhe zvogëlimit të mbeturinave të ushqimit.**
Sa i përket standardeve të mirëqenies së kafshëve, MBPZHR siguroi modele specifike të fermës për aplikuesit e granteve, por këto standarde mungojnë në sistemin e kontrollit të Agjencisë së Veterinarisë. Është një fakt i njohur se standardet e mirëqenies së kafshëve po zvogëlojnë përdorimin e antimikrobikëve. Sidoqoftë, si në rastin e çdo standardi, kështillohet një qasje e kujdesshme: imponimi i standardeve në kohë të shkurtër, pa fushata ndërgjegjësimi dhe sigurim të mbështetjes financiare për zbatimin e tyre, nuk do të çojë në rezultatet e pritshme.
Kosova ka interes të promovojë prodhuesit e saj vendorë, përfshirë ata që vazhdojnë traditat e lashta. Bujqësia në shkallë të vogël po i përgjigjet plotësisht përkufizimit të bujqësisë së qëndrueshme, pasi është në dobi të mirëqenies së kafshëve dhe është me një përdorim të ulët të kimikateve dhe antimikrobikëve. Me një avantazh të jashtëzakonshëm të kullotjes ekstensive, racave lokale dhe bujqësisë me input të ulët, produktet vendore janë të një cilësie shumë të lartë.
Kosova aktualisht po e humb mundësinë për të vlerësuar produktet e saj vendore të cilësisë së lartë. Një etiketim i detajuar (përfshirë logo-n) i produkteve tradicionale vendore (të cilat mund të konsiderohen të qëndrueshme dhe me kimikate të ulëta), nën një sistem kontrolli të vleftësuar dhe të besueshëm, me fushata ndërgjegjësimi dhe veprime reklamuese (për lidhjen e këtyre produkteve me konceptin e ushqimit të shëndetshëm dhe ruajtjen e traditave) mund të ofrojë mundësi më të larta në treg për produktet vendore, duke nxitur fermerët e tjerë për ruajtjen ose adoptimin e praktikave të qëndrueshme.

25 LEADER dhe CLLD të shpjeguara - https://enrd.ec.europa.eu/leader-clld/leader-toolkit/leaderclld-explained_en

5.3.4 Barazia gjinore dhe përfshirja sociale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës "siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore" (Neni 7). Për më tepër, administrata publike e Kosovës ka marrë parasysh Direktivën e riformuluar të BE-së (2006/54/EC) për mundësitë e barabarta dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave në punësim dhe profesion.

Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Bujqësisë në vitin 2014 vetëm 11 % të grave kishin në pronësi shtëpi/banesa ndërsa, vetëm 4.9 % e tokave bujqësore ishin në pronësi të grave, përkatësisht vetëm 6,388 nga 130,436 prona. Përkundër vendosjes së kuadrit ligjor¸ ka raste që normat sociale i pengojnë gratë të realizojnë të drejtën në pronë duke përshirë edhe trashëgiminë, e që si rrjedhojë kufizon qasjen e tyre në financa dhe dobëson gjendjen e tyre ekonomike. Megjithatë, Ministria i ka ndërmarrë të gjitha masat që pjesëmarrja e grave në procesin e vendimmarrjes do të sigurohet dhe të vazhdojë në të gjitha fazat e përgatitjes dhe zbatimit të kësaj Strategjie, me synimin për t'u dhënë grave një mundësi të barabartë dhe reale për qasje dhe përfitim nga fondet. U zbatuan dhe do të zbatohen veprime afirmative, si p.sh. pikët më të larta për grantet dhe mundësitë e barabarta për qasje në pagesa direkte. Ndërhyrjet do të synojnë respektimin e plotë të të drejtave të çdo individi, duke përfshirë minoritetet dhe grupet e cenueshme shoqërore. Mekanizmi i ndërhyrjeve do të përfshijë veprime për garantimin e mundësive të barabarta dhe reale për minoritetet dhe grupet e cenueshme shoqërore për qasje dhe përfitim të fondeve. Veprimet për qasjen e tyre në informacion duhet të përfshijnë fushata të veçanta informative dhe sesione trajnimi. Të gjitha dokumentet zyrtare do të përgatiten në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërsa faqet zyrtare të internetit do t'i postojnë të gjitha dokumentet zyrtare në të dyja gjuhët.

Matrica SWOT Forcimin e strukturës socio-ekonomike të zonave rurale

PËRPARSITË	**DOBËSITË**
Ekonomia rurale dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale	***Ekonomia rurale dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale***
- Disponueshmëria e burimeve natyrore (malet, pyjet, toka, uji, etj.), zonat e mbrojtura dhe peizazh tërheqës; - Tradita në përpunimin e prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare; - Pyjet e pasura me produktet jodrusore të malit; - Shumëllojshmëria e trashëgimisë kulturore; - Disponueshmëria e burimeve njerëzore/nde në dispozicion fuqia punëtore e re; - Qasja shumë e mirë në internet; - Përvoja e gjatë në bimët aromatike dhe mjekësore (MAP), grumbullimin dhe tregtinë;	- Zhvillimi i ulët ekonomik i zonave rurale (duke përfshirë bioekonomin); - Vështirësitë në qasje në financa për fillimin e biznesit (mungesa e burimeve financiare); - Aktivitete jobujqësore dobët të zhvilluara në zona rurale; - Ndërlidhja e turizmit rural me sektorin e bujqësisë; - Promovimi për produktet tradicionale; - Mungesa e njohurive, trajnimeve, mungesa e shërbimeve këshilluese dhe qasja në trajnime profesionale; - Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar; - Infrastruktura e dobët rurale, menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimi, furnizimi me energji stabile, ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza, dhe rrugëve fushore; - Infrastruktura dhe cilësi e dobët e rrugëve fushore; - Shërbime të dobëta publike (mungesa e çerdheve, mungesa e institucioneve parashkollore, kujdesit për fëmijë pas mësimit,

	kujdesit për të moshuar); - Zvogëlimi i produkteve jodrusore të malit për shkak të mbigrumbullimit dhe mbikëqyrjes së dobët të grumbulluesve të licencuar; - Bashkëpunim i dobët ndërmjet komunave për promovimin e iniciativave të integruara të zhvillimit; - Kapacitetet e pamjaftueshme të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (trajnime, IT etj.) - Investime të pamjaftueshme në zinxhirit e vlerës, veçanërisht objektet e tharjes dhe ruajtjes - Kapacitet i kufizuar administrativ për marketingun e produkteve vendore; - Përdorimi i pakontrolluar i pesticideve, vjelja e tepërt e PPJD-ve dhe BMA-ve të egra dhe ndotja me plastikë; - Infrastruktura e dobët publike rurale (rrugët, furnizimi me ujë dhe veçanërisht sistemet e ujërave të zeza dhe trajtimit), pyjet dhe rrugët bujqësore.
Zhvillimi lokal - Ekzistojnë GLV; - Ekziston eksperienca institucionale ne menaxhimin e LEADER-it; - Ekziston eksperienca në përgatitjen e SZHL; - Ekziston Rrjeti i GLV.	**Zhvillimi lokal** - Burimet financiare për funksionimin e drejtë të GLV; - Ekspertizë në menaxhimin e GLV–ve; - Vetëdija për rëndësinë e Qeverisjes Lokale dhe veprimeve te qasja LEADER; - Masat aktuale mbështetëse nuk janë në përputhje me idenë e BE-së për LEADER për zbatimin e projekteve; - Definimi i statutit ligjor te GLV-ve ekzistuese; - **D**efinimi i shpenzimeve operative/administrative; - Kapacitetet njerëzore të dobëta për zbatimin e qasjes LEADER në AZHB; - Mungesa e procedurave për zbatimin e qasjes LEADER; - Mungesa e afateve (afati kohor i hapur) për kërkesë të pagesave për shpenzime operacionale; - GLV-të nuk janë ende gati për marrjen e përgjegjësive më të larta pa trajnime të mëtejshme.
MUNDËSITË **Ekonomia rurale dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale** - Fillimi i biznesit shumë i lehtë (regjistrimi i biznesit); - Kërkesa për produkte tradicionale bujqësore /kërkesë e tregut për produktet mjekësore	**KËRCËNIMET** **Ekonomia rurale dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale** - Shpopullimi dhe plakja e popullsisë në zonën rurale; - Humbja e interesit te të rinjtë për t'u bërë ekonomikisht aktivë në bujqësi/zonat rurale;

dhe aromatike, produktet jodrusore të malit dhe për produktet e prodhuara në ekonomi familjare; - Kërkesa e rritur për ofrimin e shërbimeve për turizmin rural; - Lidhëshmëria e ngushtë midis zonave rurale dhe urbane; **Zhvillimi lokal** - BE-ja vazhdon ta mbështesë qasjen LEADER; - Interesi i fortë i autoriteteve lokale për të përgatitur dhe zbatuar SZHL; - Mundësi më të lehta për të mundësuar fonde të huaja; - Interesi për themelimin e GLV-ve të reja; - Interesi për aktivizimin e GLV-së ekzistuese.	- Punësimi joformal i përhapur gjerësisht; - Standardet e produkteve të ulëta; - Standardet e shërbimit nuk përputhen me pritjet e klientëve të mundshëm; - Degradimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore; - Shfrytëzim i pakontrolluar i pasurisë natyrore; - Dispozita të paqarta në lidhje me lejet e ndërtimit në zonat rurale; - Rritja e kostove të punës dhe mungesat në tregun e punës; **Zhvillimi lokal** - Buxheti jo i qëndrueshëm; - Vonesa në alokimin e buxhetit për GLV; - Vonesa në pagesa për përgatitjen e SZHL dhe për shpenzime operative; - Rrezik prej mossigurimit të mjeteve për bashkëfinancimin e projektit publik; - Vonesa e pagesave.

6. LIDHJA E PROBLEMEVE TË IDENTIFIKUARA ME OBJEKTIVAT

6.1 Problemet kryesore të identifikuara – bujqësia dhe sektori gro ushqimor

Kosova ka kushte të mira natyrore për bujqësinë dhe tradita të forta në prodhimin e pemëve, perimeve, rrushit dhe në mbarështimin e kafshëve. Gradualisht, legjislacioni (për tokën bujqësore, ujitjen, planifikimin hapësinor, sistemin e trajnimit dhe këshillimit etj.) dhe planifikimi (p.sh., për ujitjen, për zhvillimin e "komunave" etj.) janë përmirësuar. Me një buxhet më të lartë për subvencione dhe grante dhe kontribute donatorësh, një trend i rritur i çmimeve bujqësore dhe konsolidim të disa kanaleve tregtare, është rritur interesi për bujqësinë komerciale. Për më tepër, standardet e sigurisë ushqimore dhe kapaciteti përpunues u përmirësuan për impiantet agro-përpunuese. Kapaciteti institucional për menaxhimin e fondeve të ngjashme me IPARD u konsolidua gjithashtu. Vitet e fundit është vërejtur një proces riorientimi drejt tregut dhe kulturave me vlerë më të lartë të shtuar.

Megjithatë, bujqësia në shkallë të vogël mbetet dobësia kryesore strukturore. Inputet e shtrenjta dhe qasja e vështirë në kapitalin financiar, pajisjet dhe makineritë e vjetra dhe të pamjaftueshme bujqësore, infrastruktura e dobët bujqësore (p.sh., sistemet e ujitjes, rrugët bujqësore, etj.) po çojnë në vlerën e shtuar më të ulët për njësi pune vjetore në bujqësi në krahasim me BE-në dhe vendet fqinje.

Depot (me pajisje për klasifikim dhe paketim) dhe veçanërisht depot e ftohta (që do të mbështesnin eksportin me çmime më të larta në tregun e BE-së) janë të pamjaftueshme për të gjitha llojet e produkteve bujqësore.
Fermerët e rinj janë një shqetësim i veçantë. Niveli i lartë i papunësisë dhe migrimit po e privon sektorin nga puna e aftë dhe mundësitë e tij për një modernizim më të shpejtë.
Me pak shoqata organizative bujqësore, fermerët janë pa fuqi negociuese të tregut dhe pa përparësitë e bashkëpunimit (p.sh., përdorimi i përbashkët i makinerive, magazinave etj.), dhe nuk ka bazë ligjore specifike për organizatat e prodhuesve.
Praktikat e mira për menaxhimin e plehut organik dhe përdorimin efikas të plehrave dhe pesticideve nuk rregullohen, as nuk promovohen përmes rrjeteve të transferimit të njohurive ose trajnimeve. Në përgjithësi, fermerët nuk kanë qasje të mjaftueshme në informacion dhe njohuri.
Përkundër arritjes së një kapaciteti të mirë të përpunimit dhe standardeve të larta të sigurisë ushqimore për disa prej përpunuesve, sektori ka nevojë për mbështetje për plotësimin e standardeve dhe përshtatjen me kërkesat e tregut. Pa integrim vertikal, ekziston një rrezik i lartë i rritjes së importeve, veçanërisht i qumështit dhe mishit (të ngrirë).
Përderisa është bërë progres shumë i rëndësishëm në grumbullimin e të dhënave në vitet e fundit, akoma mungojnë tregues të rëndësishëm bazë për përgatitjen e një politike bujqësore të orientuar drejt BE-së. Në nivel administrativ, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë mbetet dobësia kryesore, veçanërisht në sigurimin e funksionimit sipas procedurave të qarta dhe nën një sistem të sigurt të TI-së për kontroll dhe pagesa.
Në nivelin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, mungesa e programeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve vështirëson eksportet bujqësore dhe produktet e tyre . Mungon një klasifikim i të gjitha ndërmarrjeve ushqimore dhe të gjitha ndërmarrjeve që trajtojnë nënprodukte me origjinë shtazore bazuar në acquis të BE-së, si dhe një sistem operativ për grumbullimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore. Ekziston gjithashtu një kapacitet i dobët institucional për të monitoruar dhe kontrolluar tregun dhe përdorimin e PPP, përfshirë importet.

6.2 Problemet kryesore të identifikuara – toka bujqësore dhe burimet natyrore

Humbja e tokës bujqësore dhe zvogëlimi i sipërfaqes për shfrytëzimin e prodhimtarisë bujqësore dhe fragmentimi i tokës bujqësore janë një ndër sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.

Megjithatë, Kosova ka peizazhe të mahnitshme të siguruara nga malet dhe zonat e mëdha të mbuluara me pyje. Burimet natyrore (uji, toka dhe ajri) janë nën një presion të ulët për shkak të menaxhimit ekstensiv të tokës bujqësore (inputet e ulëta kimike, dendësia e ulët e kullotjes dhe fermat e kufizuara intensive të blegtorisë).

Biodiversiteti shumë i pasur mbahet nga pyjet dhe kullotat e gjera, por mbulimi i zonave të mbrojtura është mjaft i vogël (të paktën në krahasim me vendet e BE) dhe nuk ka plane menaxhimi në vend. Zonat e mundshme për Natura 2000 janë identifikuar. Emetimet e gazrave serrë (GHG) dhe amoniakut janë të ulëta, për shkak të sektorit të pazhvilluar mjaftueshëm të blegtorisë. Bujqësia ekstensive mund të shihet edhe si bujqësi e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. Pyllëzimi shihet si një zgjidhje për sekuestrimin e karbonit, duke pasur potencialin e trajtimit të çështjeve të erozionit të tokës dhe rritjen e biodiversitetit të lidhur me pyjet.

Sfida paraqesin intensifikimi i bujqësisë në ultësira dhe braktisja e tokës në zonat e thella. Intensifikimi çon në cilësi të ulët të ujit dhe ndikon në biodiversitetin, ndërsa braktisja e tokës po kërcënon kullotat me vlerë të lartë natyrore. Me gjithë cilësinë e tyre të lartë, erozioni i tokës është një fenomen i përhapur gjerësisht. Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit shpesh nuk është e rregulluar dhe nuk ka restaurim të duhur të tokës në gurëthyes. Ndërtimet pa leje në tokat bujqësore mbesin një problem i rëndësishëm. **Bujqësia organike ka përparësinë e kërkesës për eksport dhe çmimeve më** të larta, por sistemi kombëtar për inspektimet dhe certifikimin nuk është ende funksional dhe prodhuesi nuk po merr ndonjë pagesë shtesë.

Mungesa e legjislacionit mjedisor dhe zbatimi i dobët i sundimit të ligjit janë boshllëqet kryesore institucionale, së bashku me mungesën e marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Nga ana tjetër, promovimi i mbrojtjes së mjedisit përmes kufizimeve të imponuara në bujqësi dhe kërkimi i investimeve të kushtueshme pa i ofruar sektorit privat mjetet për të respektuar legjislacionin do të ishin kundërproduktive. Në të njëjtën kohë, ekziston një gamë e gjerë për praktikat e mira që nuk kërkojnë investime financiare specifike.

Hartimi i politikave vuan nga mungesa e treguesve bazë mjedisorë, ndërsa ndërgjeshmëria për mjedisin dhe veçanërisht për zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike është e ulët. Skemat e subvencioneve nuk janë të lidhura me praktikat e mira bujqësore dhe mjedisore (PMBM) dhe nuk zbatohen skema agro-mjedisore. Pa legjislacion mbi menaxhimin e plehut organik, grantet e zhvillimit rural për fermerët janë instrumentet më të avancuara të politikave në dhënien e udhëzimeve për mbrojtjen e ujit përmes ruajtjes së duhur të plehut organik. Rregullat për aplikimin e plehrave dhe pesticideve në terren nuk janë formuluar; praktika nuk kontrollohet.

Në rastin e Kosovës, përveç rastit të zonave të goditura nga nxjerrja e rërës dhe zhavorit, kujdesi ndaj mjedisit duhet të ketë të bëjë më shumë me mbrojtjen, sesa me restaurimin. Vendi ka shansin të vazhdojë me ritmin e gjelbërimit të politikës bujqësore në dobi të qytetarëve të tij, ndërkohë që natyra ende është në një status të mirë.

6.3 Problemet kryesore të identifikuara – zonat rurale dhe infrastruktura socio-ekonomike

Ekonomia rurale ka mundësinë të zhvillohet duke u mbështetur në burimet natyrore (të tilla si toka pjellore dhe pyje të gjera), peizazhe dhe tradita të bukura në përpunimin e ushqimit, që përputhen me një kërkesë në rritje për produktet tradicionale dhe turizmin rural. Hapja e një biznesi është relativisht e lehtë në Kosovë, ndërsa bizneset e reja ende mund të mbështeten në disponueshmërinë e fuqisë punëtore. Kërkesa e fortë e tregut të jashtëm për bimët mjekësore dhe aromatike dhe për produktet pyjore jodrusore çoi në zhvillimin e qendrave të grumbullimit dhe kanaleve të konsoliduara tregtare.
Ekziston një përvojë e mirë në nivelin qendror dhe lokal për përgatitjen dhe zbatimin e iniciativave të zhvillimit lokal (duke përfshirë përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal) dhe një interes në rritje për këtë qasje. Megjithatë, zhvillimi ekonomik i zonave rurale mbetet shumë i dobët. Përqindja e lartë e bizneseve dhe fuqisë punëtore të paregjistruar, niveli i lartë i migrimit nga zonat rurale (veçanërisht të rinjve), mungesa e kapitalit financiar për investime, fuqia punëtore e kualifikuar e padisponueshme dhe infrastruktura e dobët rurale (duke përfshirë infrastrukturën sociale, si p.sh. kopshtet e fëmijëve) janë pengesa të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë rurale. Mungon menaxhimi i mbeturinave dhe veçanërisht riciklimi, ndërsa hedhja ilegale e mbeturinave përgjatë rrugëve dhe rrjedhave të ujit është një praktikë e zakonshme. Disa dobësi të tjera specifike që vlen të përmenden: turizmi rural nuk është zhvilluar si agroturizëm, mungesat e zinxhirit të vlerave për ruajtjen, tharjen, paketimin dhe etiketimin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe produkteve pyjore jodrusore, dobësojnë tregtimin e produkteve vendore.

Në nivel administrate, Agjencisë së Pagesave i mungojnë procedurat e përshtatura për të siguruar një funksionalitet me kohë të plotë të GLV-ve. Gjithashtu, GLV-të nuk janë ende të fuqizuara, as teknikisht të gatshme për të nisur thirrje të hapura për përzgjedhjen e projekteve që duhet të përshtaten me prioritetet vendore. Shërbimet këshilluese ende nuk po i trajtojnë siç duhet çështjet e biznesit rural. OJQ-t lokale (për mbrojtjen e mjedisit, fuqizimin e grave, zhvillimin e qëndrueshëm etj.) janë një burim i vlefshëm që mund të përfshihet në mënyrë efikase në zhvillimin e zonave rurale.

6.4 Problemet kryesore në nivel të institucioneve publike

Kosova është vend kandidat potencial për në BE dhe ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) e cila ka hyri në fuqi në prill 2016, duke siguruar një kornizë gjithëpërfshirëse për një dialog të strukturuar politik dhe intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike. Në këtë kontekst, Kosova duhet të rrisë konkurrueshmërinë e saj bujqësore për t'i rezistuar presioneve të tregut të hapur, duke miratuar *acquis* të BE-së që përfshin standarde të shumta. Prandaj, *acquis* i BE-së po sjell sfida institucionale në lidhje me transponimin dhe kapacitetin institucional për monitorimin dhe kontrollin e legjislacionit të ri, si dhe sfidat e sektorit privat, për të mbuluar kostot për investimet e reja dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre të mëtejshme.

Një boshllëk horizontal lidhet me digjitalizimin e institucioneve (përfshirë marrëdhëniet e tyre me publikun / fermerët) dhe përfshirjen e dobët të inovacionit në rrjetet e transferimit të njohurive.

Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, boshllëku kryesor lidhet me funksionimin e duhur të Agjencisë së Pagesave (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë). Kapaciteti i dobët institucional dhe

[26]IACS - Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit, që nënkupton sistemin e siguruar të TI-së që përfshin të gjitha detajet dhe verifikimet për kërkesat e pagesave, duke filluar nga paraqitja e kërkesave, deri në regjistrimin në kontabilitet

mungesa e një sistemi të besueshëm mbikëqyrjeje për të siguruar përputhshmërinë me procedurat e brendshme të miratuara po rrezikon rolin e institucionit në ofrimin e mbështetjes financiare për

fermerët. Sistemet e TI- së duhet të forcohen drejt një IACS të plotë[26], duke siguruar një regjistër të plotë pa mundësi fshirjeje të të gjitha veprimtarive të përdoruesve dhe i cili duhet të lidhet me bazat e të dhënave të tjera kombëtare për të lejuar kontrolle tërthore. Në nivel administrativ, dobësia kryesore mbetet Agjencia e Pagesave, veçanërisht në sigurimin e funksionimit të saj me procedura të qarta dhe me një sistem të sigurt IT për kontroll dhe pagesa. Për më tepër, mungon një sistem monitorimi ex-post për projektet e zbatuara, duke i lënë autoritetet pa një situatë të qartë mbi përdorimin e duhur të granteve pas përfundimit të kontratave / pagesës së fundit.

Për më tepër, vlerësimi i ndikimit të masave të grantit duhet të kryhet në kohën e duhur, duke çuar, së bashku me rezultatet e studimeve sektoriale dhe nevojat e identifikuara në strategjinë kombëtare për bujqësinë, zhvillimin rural dhe pylltarinë, në ndryshimet në mekanizmin e financimit si IPARD, veçanërisht për dispozitat që lidhen me përshtatshmërinë, pikëzimin dhe sistemin e monitorimit.

Sistemit të thjeshtuar të identifikimit të parcelave të tokës i është dashur një përditësim i rregullt për shkak të dinamikës së ndryshimeve të tokës dhe gjithashtu një përditësim që duhet të ndalojë kërkesën për pagesa direkte nga fermerë të ndryshëm për të njëjtën parcelë. Skemat e subvencioneve dhe granteve të administratës vendore duhet të bëhen pjesë e Strategjive të Zhvillimit Lokal dhe të menaxhohen përmes Grupeve Lokale të Veprimit, duke siguruar kështu qëndrueshmëri me politikat kombëtare duke vazhduar adresimin e nevojave lokale.

Ende nuk ka ndonjë kusht të lidhur me pagesat direkte, kështu që fermerët ende nuk janë nxitur të miratojnë standarde të reja. Megjithatë, së bashku me kërkesat e reja për pagesat direkte, duhet të krijohet një Sistem Këshillimor për Fermat (SSHK), i cili do të koordinojë dhe japë këshillimin e duhur për miratimin e standardeve të reja. Boshllëqe të tjera të rëndësishme lidhen me kapacitetin institucional për akreditimin e organeve të certifikimit dhe inspektimit në bujqësinë organike dhe me mungesën e legjislacionit dhe skemave mbështetëse për organizatat prodhuese.

Sa i përket **sigurisë ushqimore, politikës veterinare dhe fitosanitare**, me përjashtim të mishit të shpezëve, mungesa e programeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve po bllokon eksportet dhe me këtë, zhvillimin e sektorit blegtoral dhe të industrisë ushqimore të produkteve të mishit.

Mungon një klasifikim i të gjitha ndërmarrjeve ushqimore dhe të gjitha ndërmarrjeve që trajtojnë nënprodukte me origjinë shtazore bazuar në acquis të BE-së. Një fabrikë për përpunimin e mbetjeve shtazore është bërë teknikisht funksionale, por nuk ka një sistem operativ për grumbullimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore. Për më tepër, pa rregulla që lidhin sistemet e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve me pagesa direkte (për IACS -in e ardhshëm), përdorimi i kësaj baze të dhënash nuk stimulohet. Regjistrimi i duhur i lëvizjeve të kafshëve është i një rëndësie të veçantë.

Ndonëse është bërë progres shumë i rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave në vitet e fundit, ende mungojnë tregues të rëndësishëm bazë për përgatitjen e një politike bujqësore të orientuar drejt BE-së.

Sa i përket **çështjeve fitosanitare**, nevojitet ngritja e kapaciteteve institucionale për të monitoruar dhe kontrolluar tregun dhe përdorimin e PPP, përfshirë importet. Sa i përket **peshkimit**, ka boshllëqe të rëndësishme në përgatitjen e një inventari të llojeve të peshkut dhe në përafrimin e politikave të tregut me acquis të BE-së (p.sh. moslejimi në tregje i llojeve të ndaluara) dhe më tej, duhet të zbatohet një sistem kontrolli.

Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë është të japë një kontribut të balancuar në ekonominë, mjedisin, shoqërinë dhe mirëqenien kulturore të zonave rurale dhe të Kosovës në tërësi, përmes një partneriteti efikas dhe fitimprurës ndërmjet sektorit privat, qeverisë qendrore, lokale dhe komuniteteve në kontekstin evropian.

7. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028 pasqyron nevojën për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, për të konkurruar në tregjet e Bashkimit Evropian dhe tregjet rajonale. Identifikon masat për rritjen e efikasitetit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut bujqësor; ndërtimin e institucione të duhura, efektive publike dhe private; për të përmirësuar të ardhurat e fermave; për të siguruar që konsumatorët të kenë qasje në ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm; për të optimizuar përdorimin e burimeve të tokës, pyjeve dhe ujit, në një mënyrë të qëndrueshme mjedisore; dhe për të ndërtuar komunitete rurale të qëndrueshme përmes zhvillimit të qëndrueshëm rural.
Sipas analizave te përmbledhura; analizës SWOT dhe analizës sektoriale janë identifikua objektivat strategjike dhe specifike, të cilat janë:

7.1 Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të

Objektivi specifik 1.1: Mbështetja e të ardhurave të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore
Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit të tregut duke përfshirë fokus më të madh në kërkimin, inovacionin, teknologjinë dhe digjitalizimin
Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës

